

Gruevski
Ka afat 8 ditë
që të paraqitet
në burg

Fq.4



**MUNGESA E
INFERMIERËVE**

Pasoja në kujdesin
e pacientit

Fq.7



**VITI
I MBRA-
PSHTË**

Forum

Fq.10



Koha

www.koha.mk



**KOHA për
enigmë**

Fq.12-14

EDITORIAL |||||

**(Pa)fajësia
dhe kutet**



“Presumpcioni i pafajësisë” nuk është i vetmi me të cilin ndeshemi, por dhe kuti që e imponon praktika në një shoqëri. A kemi kut të njëjtë? Ndaj kryeministrit Zaev zhvillohej proces gjyqësor që para se ta merrte mandatin, dhe ai proces ka vazhduar edhe pasi u bë kryeministër! Pse nuk kërkohej dje nga Zaevi, ajo që kërkohej sot nga ministri shqiptar i qeverisë së tij? **Fq.10**

RAJON |||||

**Përfaqëuesit
e Luginës e
ftojnë Thaçin
t’i vizitojë**

Fq.16

GLOBI |||||

**Princi Salman
urdhëroi
vrasjen e
Khashoggit**

Fq.17



PROPOZIM-NDRYSHIMET KUSHTETUESE

NJË HAP PRANË NATO-S APO STATUS QUOS?



Shkup, 19 tetor - Pas filitrit që kaluan në Qeverinë e Maqedonisë, ndryshimet kushtetuese, që parashihen me marrëveshjen e nënshkruar në Prespë mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë, erdhën më në fund në Kuvend. Kushtetuta e Maqedonisë do të pësojë ndryshime në katër nene, më së voni deri në janar të vitit 2019. Ja çfarë përmban propozimi për ndryshimet Kushtetuese: Në të gjithë Kushtetutën e shkruar të Republikës së Maqedonisë para fjalës Maqedoni do të shtohet parashtesa ‘e Veriut’. Në përputhshmëri me preambulën dhe marrëveshjen me Greqinë, preambula do të pësojë disa ndryshime. Në nenin 3 të Kushtetutës së Maqedonisë është rregulluar se territori i Republikës së Maqedonisë është i pandashëm dhe patjetërsueshëm. Nën Nenin 49 të Kushtetutës është shkruar se Republika e Maqedonisë kujdeset për gjendjen e të drejtat për komunitetin maqedonas në vendet fqinje dhe mërgimtarët. Ndihton në zhvillimin e tyre kulturor dhe avancoon lidhjen me ta.

"Monstra", është e dyshimtë ekspertiza e armës!

Shkup, 19 tetor -Për shkak të vendimit të Gjykatës Supreme për rigjykimin e rastit “Monstra” e gjithë procedura penale kundër të dyshuarve për vrasjen e pesëfishtë në Liqenin e Smilkovës, duhet të përsëritet. Edhe pse opinioni është në pritje të publikimit të provave të reja nga Prokuroria Speciale Publike, megjithatë një gjë e tillë sipas familjarëve akuzuarve për rastin “Monstra”, nuk pritet të

ndodhë së shpejti. Duke u mbështetur në dispozitat e vjetra të Ligjit për procedurë penale dhe aktakuzën e ngritur nga Prokuroria për krim të organizuar, prokurorët Trajçe Pelivanov dhe Artan Ajro të premtën kanë prezantuar në seancën ku janë prezantuar rrëfimet e personave ekspert në rastin “Monstra”. Punojnësit e MPB-së, respektivisht pjesëtar të Sektorit për krim teknik... **Fq.5**





VENDE NË TË CILAT DËNOHET SHPIFJA ME BURG

Vendet që dënojnë shpifjen me burg janë: Gjermania, Holanda, Belgjika, Austria, Spanja, Italia, Suedia, Danimarka, Finlanda, Portugalia, Greqia, Islanda, Turqia, Polonia, Letonia, Lituania, Republika Çeke, Sllovakia

Instituti Ndërkombëtar i Medias (International Press Institute) ka në faqen e tij zyrtare të internetit legjislacionin e vendeve evropiane që dënojnë shpifjen nga gjobë deri në burgim.

Kodi i Procedurës Penale të Gjermanisë dhe Austrisë parashikojnë dënim me gjobë dhe burg për shpifjen.

Sipas nenit 186 të Kodit gjerman të Procedurës Penale, shpifja përcaktohet si "pohim apo shpërndarje e një fakti të lidhur me një tjetër person, që mund të dëmtojë reputacionin e tij apo mund të ndikojë negativisht në opinionin publik për të", transmeton "ATSH".

Ajo dënohet me gjobë apo burgim deri në një vit. Një dënim me burg deri në dy vite mund të vendoset nëse veprimi është "kryer publikisht apo nëpërmjet shpërndarjes së materialeve".

Ndërkohë, sipas nenit 187 të këtij kodi, përgojimi konsiston "në një deklaratë shpifëse, të cilën folësi e di që është false dhe që përdoret për të dëmtuar reputacionin e personit apo për të rrezikuar besueshmërinë e tij". Dënimi është gjobë apo burgim deri në dy vite. Dënimi deri në pesë vjet mund të vendoset nëse veprimi është bërë publikisht apo nëpërmjet medias.

Ndërkohë, Kodi austriak i Procedurës Penale, në nenin 297 përcakton se shpifja është të akuzosh dikë për një veçori ose prirje të keqe, sjellje të pandershme ose një sjellje fyese ndaj moralit të mirë, që mund ta denigrojë atë person ose mund ta dëmtojë atë në sytë e publikut.

Dënimi përfshin gjashtë muaj burg ose me gjobë të barazvlefshme me 360 ditë pune. Për shpifje të kryer nëpërmjet medias, televizionit "ose me ndonjë mjet tjetër nëpërmjet të cilit përmbajtja e shpifjes është bërë e arritshme për një publik më të gjerë", ndëshkimi i mundshëm është deri në një vit burg ose gjobë të barazvlefshme me 760 ditë pune.

Për përgojimin, kodi austriak thotë se është "të akuzosh një person tjetër gabimisht dhe me vetëdije për një vepër penale, për moszbatim të një detyre zyrtare, në atë mënyrë që e vë personin në rrezik për ndjekje penale. Dënimi është deri në një vit burg ose gjobë e barazvlefshme deri në 720 ditë pune.

Megjithatë, nëse akuza ka të bëjë me një vepër penale që dënohet me burgim mbi një vit, dënimi përfshin gjashtë muaj deri në pesë vjet burg.

Vendet që dënojnë shpifjen me burg janë: Gjermania, Holanda, Belgjika, Austria, Spanja, Italia, Suedia, Danimarka, Finlanda, Portugalia, Greqia, Islanda, Turqia, Polonia, Letonia, Lituania, Republika Çeke, Sllovakia.

Blerja e librit si detyrë morale dhe kulturore

"Më ka ardhur vërtet shumë mire kur Klodeta Gjini, nëpërmjet blogut të saj, u bë lajmëtarja e parë e botimit të romanit tim në Itali. Dhe po ju them pse. Klodeta është pa dyshim një rekordmene e paharrueshme në historinë e sportit shqiptar. Por sukseset e saj nuk janë kujtime. Sot ajo ka një jetë të re në Itali dhe ka arritur në pak vite rekorde të reja, deri edhe të japë mesim në Universitetin e Bolonjas, një nga universitetet më të vjetra e me të njohura të botes. Gjatë viteve 1992-1997 kam jetuar në Francë si ambasador. Kam patur rastin dhe kenaqesinë të pritem si mik në qindra familje emigrantesh shqiptare. Kam parë në bibliotekat e tyre shpesh shumë libra. Autorë francezë, amerikanë, japonezë, me një fjale nga e gjithë bota. Por shumë rrallë librat e Ismail Kadarese. Kjo më shkaktonte një trishtim. Pse kjo shpërfillje? pyesja veten. Dhe me kujtohet një bisede me botuesin tim francez. Fjala ishte pse çdo botues francez, në çdo sezon letrar sjell në katalog me shumë se një liber të një autori hebre. Kaq shumë vlera letrare cilesore krijohen hebrejtë? e pyeta botuesin. Nuk ka rëndësi, m'u pergjig ai. Të gjithë hebrejtë e Francës e ndjejnë për detyrë morale dhe kulturore ndaj kombit të tyre të blejnë më shumë se një kopje të çdo libri. Një për vetë dhe një për ta dhuruar një jo hebreu. Kështu ata e inkurajojnë botuesin të vazhdojë. Dhe i japin kulturës së tyre atë përhapje që dihet. Po shqiptaret pse nuk e bëjnë një gjë të tillë? pyesja veten. Ne, shkrimtarët shqiptarë që për thehemi dhe botohemi të shtëpite botuese serioze në bote jemi shumë të pakët. Me gishtat e njeres dore numerohemi. Pse pra bashkëdhetarët tanë nuk ndjejnë kureshtje të na lexojnë dhe të tërheqin vëmendjen e të tjerëve mbi veprën tonë?", ka shkruar një status në Facebook, shkrimtari Besnik Mustafaj.

Zbulohet dokumenti për zhdukjen e çështjes Çame

"Zbulohet dokumenti, mbi 10 milion euro financime për zhdukjen e PDIU, çështjen Çame dhe nxjerrjen jashtë politikës Shpëtim Idrizin. Në lojë Edi Rama, Dhimitër Bushati dhe shumë njerëz të tjerë, skenarë i përgatitur mirë që më 2014. Goditje pas shpine dhe nën brez për PDIU, Idrizin, dhe Çamët, dokumentet do botohen në një të ardhme të shpejtë. I tërë fondi kap shumë 45 milion euro, Fondi Sekret Nikos Kotzias. SHISH disponon tërë skenarin. MJERË SHQIPTARËT ÇFARË LUHET", ka shkruar një status në Facebook, historiani Arben Llalla.

MEDIA Citate

Zviceranët janë më të pasurit në botë

Pavarësisht një rënie të lehtë, zviceranët ende pasurinë mesatare më të lartë për një të rritur, sipas një raporti të "World Wealth Report" nga "Credit Suisse".

Sipas raportit, pasuria mesatare e një të rritur zviceran është 530,240 dollarë (577,707 franga), derisa vitin e kaluar ishte 537,600 dollarë, shkruan albinfo.ch.

Zvicra është në vendin e parë, e ndjekur nga Australia (\$ 411,060) dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (403,970 \$).

Matur në franga zvicerane, pasuria familjare u rrit 39% që nga viti 2000 (129% në dollarë, kryesisht për shkak të vlerësimit të frangut zviceran kundrejt dollarit).

Mbi 60% e të rriturve zviceranë kanë pasuri me vlerë më shumë se 100,000 dollarë.

Në terma të individëve të pasur, 11% e banorëve zviceranë janë milionerë, 2.650 kualifikohen si persona me vlerë të lartë neto (mbi 50 milionë dollarë) dhe 980 kanë një vlerë neto më të madhe se 100 milionë dollarë, përcjell tutje albinfo.ch.

Në Zvicër, sot ka 725,000 njerëz me pasuri prej një milion e më shumë. Ky numër pritet të rritet në 988,000 deri në vitin 2023.

Megjithatë, zviceranët kanë një nga nivelet më të larta të borxhit absolut në botë me 138,810 dollarë për të rritur. Zvicra është gjithashtu një lider në mesin e vendeve më të pasura kur bëhet fjalë për pabarazinë e pasurisë.

(Albinfo.ch, 19 tetor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

A EDINI PSE U KRIJUA INTERNETI?

Në vitin 2018, disa prej nesh betohen se përveç ushqimit, ujit dhe oksigjenit, ne gjithashtu nuk mund të jetojmë pa internet. Në një periudhë relativisht të shkurtër, ky entitet i padukshëm ka revolucionarizuar mënyrën se si shumica e njerëzve jetojnë. Por pse u zbulua interneti dhe kush e shpiku? Sa vjeç është? Si dallon nga World Wide Web?

Historia e internetit filloi me email. Përdorimi i parë komercial publik i internetit ishte përmes postës elektronike, dhe kjo ndodhi në vitin 1989. Kjo ishte kur MCI Mail dhe Comuserve nisën serverët e tyre të postës elektronike, duke lidhur rreth 500,000 përdorues për të filluar. Në të njëjtin vit, Tim Berners-Lee dhe ekipi i tij CERN shpiku World Wide Web, e cila është ajo që ne ende e përdorim sot, sa herë që nisim një shfletues interneti. Megjithatë, lin44dja e vërtetë e internetit ka ndodhur në fillim të vitit 1983. TCP/IP (një grup rregullash që rregullon lidhjen e sistemeve kompjuterike në Internet) u zbatua për

herë të parë më 1 janar 1983. Organizata amerikane përgjegjëse ishte ARPANET (Advanced Projects Administration Administration). Motivi i tyre për krijimin e internetit ende debatohet.

Stephen J. Lukasik, një kontribuues i projektit, ka thënë se interneti është projektuar "të shfrytëzojë teknologjitë e reja kompjuterike për të përmbushur nevojat e komandës ushtarake dhe kontrollin kundër kërcënimeve bërthamore, për të arritur kontrollin e mbijetuar të forcave bërthamore të SHBA-së dhe për të përmirësuar taktikat ushtarake dhe vendimet e menaxhimit".

Sidoqoftë, Charles Herzfeld, një drejtor që punoi për paraardhësin e ARPANET në vitet 1960, pretendoi se projekti ishte i motivuar nga zhgënjimi që ishte për shkak të vetëm një numri të kufizuar të kompjuterëve hulumtues të fuqishëm në vend dhe se shumë hulumtues, të cilët duhet të kishin qasje në ta, ishin të ndarë gjeografikisht prej tyre.

PALMER TË HËNËN NË SHKUP

Teksa Rusia i propozon Maqedoninë alternativën e anëtarësimit në Unionin Ekonomik Euroaziatik, Palmer para vizitës së tij në Shkup të hënën, theksoi se Marrëveshja e Prespës është e vetmja rrugë për në NATO dhe BE, dhe se alternativë tjetër nuk ka.



e mirë dhe se Rusia është kundër zgjerimit të NATO-s në Ballkan, ka reaguar zëvendës-ndihmës-sekretari amerikan për Evropë dhe Euroazi, Metju Palmer.

Teksa Rusia i propozon Maqedoninë alternativën e anëtarësimit në Unionin Ekonomik Euroaziatik, Palmer para vizitës së tij në Shkup të hënën, theksoi se Marrëveshja e Prespës është e vetmja rrugë për në NATO dhe BE, dhe se alternativë tjetër nuk ka.

Sipas tij, edhe ata politikanë në vend që mashtrorjnë opinionin se e ardhmja sigurohet edhe pa kompromiset që u arritën me Marrëveshjen e Prespës, nuk i bëjnë shërbim vendit të tyre.

“Është e rëndësishme të theksohet se e ardhmja evropiane kërkon nga Maqedonia dhe Greqia ta pranojnë dhe ta zbatojnë në tërësi Marrëveshje e Prespës. Nuk ka zgjidhje alternative, nuk ka “Prespa plus”, nuk ka diçka që na pret pas ndonjë cepi, nëse Kuvendi i Maqedonisë nuk e voton me shumicë prej 2/3 këtë marrëveshje”,- thekson Palmer.



Zaev dhe Cipras, të vendosur për marrëveshjen e Prespës

Shkup, 19 tetor - Bashkë me kryeministrin grek, Aleksis Cipras, ne mbetemi plotësisht të vendosur për perspektivën e një Ballkani të ri të shekullit XXI, ku miqësia do të rritet, bashkëpunimi do të zgjerohet dhe ne do të kontribuojmë në një përmirësim të rritjes ekonomike dhe të zhvillimit të vendeve tona, deklaroi kryeministri maqedonas, Zoran Zaev.

“Kjo do të rritë prosperitetin dhe lumturinë e qytetarëve grekë dhe maqedonas, çka do të çojë në zgjerimin e transaksioneve tregtare, investimeve të reja dhe të standardeve më të larta ekonomike”, theksoi Zaev.

Zaev tha se në një bisedë telefonike homologu i tij grek e kishte përditësuar për zhvillimet në Greqi dhe se e kishte siguruar se mbetet i vendosur ndaj marrëveshjeve të arritura duke i shpjeguar se kishte marrë përsipër edhe rolin e ministrit të Jashtëm për të siguruar zbatimin e Marrëveshjes së Prespës.

“Jam shumë i lumtur për vendosmërinë absolute të Greqisë për zbatimin e kësaj marrëveshjeje”, tha Zaev.

“Kjo mundësi nuk duhet humbur”, theksoi ai duke u bërë thirrje deputetëve për miratimin e marrëveshjes.

Shkup, 19 tetor - Pas letrës së ndihmës sekretarit Vess Mitchell, drejtuar liderit të VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski, në Shkup pritet të vijë vetë Zëvendës-ndihmës Sekretari i Shtetit për Çështjet Evropiane, Matheu Palmer. Vizita e tij të hënën bëhet me qëllim të mbështetjes së Marrëveshjes së Prespës dhe reformave të ndërmarra nga Maqedonia. Ai do të takohet me

faktorët politikë në pushtet por edhe nga opozita.

Paraprakisht në letrën e zyrtarit të lartë amerikan Mitchel drejtuar Mickovskit, shprehej zhgënjimi nga qëndrimet e drejtuesve të kësaj partie, duke përfshirë edhe kreun e VMRO-së, por Mickovski u përgjigje në letrën e tij kthyesë, se edhe pse mirëpret mbështetjen amerikane, VMRO nuk do të votojë ndryshimet ku-

shteuese me arsyetimin se edhe pse partia që drejton është pro antarësimit të vendit në NATO dhe BE, ky antarësim duhet të jetë i dinjitetshëm e jo përmes marrëveshjeve nënçmuese sic e cilëson kreu i opozitës marrëveshjen e Prespës.

Ndërkohë, pas deklaratave të ditëve më parë të ambasadorit rus në BE, Vladimir Çizhov, se Marrëveshja e Prespës nuk është

Të dielën në Shkup mbahet kongresi i tretë LBSH

Shkup, 19 tetor - Të dielën në Shkup do të mbahet Kongresi i tretë i Lidhjes Shqiptare në Botë, ku priten të marrin pjesë mbi 300 persona delegatë dhe mysafirë. Kryesia e kësaj Lidhje Shqiptare shpallosi idenë dhe platformën e këtij Kongresi. “Kjo platformë e Kongresit të Tretë e ka një domethënie për ndihmesë të çështjes sonë Kombëtare. Ta thërrasim kuptimin, ta thërrasim dashurinë e ndihmesës ndaj njëri-tjetrit dhe të kemi në vetëdije se jemi popull të një gjaku, të një gjuhe, të një flamuri”,- tha kryetari i LSHB-së, Simon Kuzhnini.

“Tendencja jonë ka qenë që të hartojmë një platformë që ka karakter mbarëkombëtar, kështu që janë marrë shumë elemente nga programet e tyre. Lidhja Shqiptare



në Botë duhet të paraqesë një strumbullar të të gjitha shoqatave”,- tha nënkryetari i LSHB-së, Milaim Fejziu. “Kemi të ftuar gjithsej 350 persona, prej të cilëve 210 janë delegatë të lidhjes. Kemi të ftuar po ashtu edhe personalitete politike dhe publike dhe Organizata jo-qeveritare”,- u shpreh kryetari i Këshillit Organizativ të Kongresit,

Shpend Bajrami. Kongresi i Tretë i Lidhjes Shqiptare në Botë mbahet në Shkup, pas dy të parave që u mbajtën në Prizren dhe Tiranë. Në këtë Kongres do të zgjidhet edhe kryetari i ri i Lidhjes, ku në garë nuk është kryetari aktual, Simon Kuzhnini, i cili ishte kryetar për dy mandate, ndërsa tani në garë janë dy kandidatë të tjerë.



Moska kritikon BE-në dhe SHBA-të për “ndërhyrje në Maqedoni”

SHBA-të dhe vendet e BE-së po ndërhyjnë në punët e brendshme të Republikës së Maqedonisë thonë nga Ministria e Jashtme e Rusisë..

Pas dështimit të referendumit më 30 shtator, e organizuar me shpresën për të marrë një kompromis nga qytetarët, Washingtoni dhe vendet e BE-së tani kanë për qëllim të nxitin ndryshimet me forcë në parlamentin maqedonas, thotë MPJ-ja ruse.

Sipas Moskës, kjo është një çështje e ndërhyrjes së pamëshirshme të Shteteve të Bashkuara dhe BE në punët e brendshme të Shkupit. Për momentin po ndodh ndërhyrja më e keqe e SHBA-ve dhe BE-së në punët e brendshme të Shkupit, që tejkalon të gjitha kufizimet e arsyeshme. Qëllimi është të çojë Maqedoninë në NATO me çdo kusht, akuzojnë nga Ministria e Jashtme Ruse.

Gazetaria e internetit, me shumë pikëpyetje

Ohër, 19 tetor - Në konferencën ndërkombëtare në Ohër ku marrin pjesë gazetarë, përfaqësues të organizatave mediatike dhe ekspertë, u konkludua se përmbajtjet cilësore mediatike zhduken si rezultat i propagandës dhe lajmeve të rreme në mediat online dhe faqet e internetit.

Mediat e Ballkanit edhe më tej janë nën presion politik, vlerëson Komunitetit mediatik i rajonit. Situata është rënduar madje me paraqitjen e numrit të madh të ueb faqeve dhe portaleve, të cilat elitat politike i shfrytëzojnë për të rritur ndikimin e tyre. Gjendja



nuk është më e mirë as në Kosovë. Në Bosnjë dhe Hercegovinë kemi pluralizëm në media, por kjo vërehet për nga numri i mediave e jo për nga cilësia e tyre.

Kjo krijon situatë të polarizuar politike ku manipulohet me informacionet e kapshme për opinionin. Edhe ato në pjesën më të madhe janë të ndarë në parti et-

nike apo politike, që nuk kontribuon për informimin e qytetarëve”- theksoi Lejla Biçakçiç, nga Qendra për gazetari hulumtuese, Sarajevë.

Ne tani kemi situatë ku çdo blloger, çdo përdorues i Twitterit është praktikisht medium në thonjëza. Si mundet në situatë të këtillë, të veçohen mediat e mira dhe përmbajtjet cilësore. Ne kemi situatë ku sondazhet tregojnë se vetëm 6% u besojnë mediave”- u shpreh Ana Petrushevskaja, nga BIRN.

Konferencën e organizoi rrjeti hulumtues ballkanik BIRN.

Vetëm një për qind është dallimi mes atyre që konsiderojnë se do të realizohet dhe atyre që konsiderojnë se nuk do të zbatohet Marrëveshja e Prespës, tregon hulumtimi i fundit i mendimit publik në Greqi, kryer nga agjencia "Puls" për televizionin grek "Skaj"

MARRËVESHJA E PRESPËS NDAN GREKËT



Athinë, 19 tetor—Siç lajmëroi korrespondentja e MIA-s nga Athina, në pyetjen: "Nga ajo që e dini apo që e keni dëgjuar deri më tani, sipas mendimit tuaj, a do të përfundohet Marrëveshja e Prespës me IRJM-në?", 44 për qind e të anketuarve dhanë përgjigje negative (31 për qind "sipas të gjitha gjasave jo", 13 për qind "sigurisht jo"), ndërsa 43 për qind përgjigje pozitive (33 për qind u përgjigjën "sipas të gjitha gjasave po", 10 për qind "sigurisht po").

Gjatë analizës së këtyre rezultateve, sipas votës së dhënë në zgjedhjet e fundit në shtator të vitit 2015, votuesit e SYRIZA-s janë ata të cilët besojnë se zgjidhja mes dy vendeve do të ektë përfundim të suksesshëm, përdërisa ndërkaq gjashtë prej 10 votuesve të Demokracisë së Re kanë dhënë përgjigje negative.

Nga votuesit e SYRIZA-s, 58 për qind (39 për qind "sipas të gjitha gjasave po" dhe 19 për qind "siguri-

sht po") dhanë përgjigje pozitive, ndërsa 35 për qind përgjigje negative.

Nga partia më e madhe opozitare, vetëm 30 për qind konsiderojnë se Marrëveshja e Prespës do të përfundohet, prëderisa, ndërkaq, 64 për qind (45 për qind "sipas të gjitha gjasave jo", 19 për qind "sigurisht jo") japin vlerësim negativ.

Lidhur me orarin e forcave në skenën politike greke, Demokracia e Re edhe më tutje është në epërsi ndaj SYRIZA-s për 10 për qind dallim. Partia opozitare, sipas hulumtimit të agjencisë "Puls" për televizionin grek "Skaj", merr 31 për qind, ndërsa partia në pushtet 21 për

qind.

Agimi i Artë është stabil në pozitën e tretë me 7,5 për qind, ndërsa pas tij janë Lëvizja për ndryshim (shtatë për qind), partia komuniste (gjashtë për qind) Potami dhe Lidhja e centralistëve (1,5 qind), përdërisa, ndërkaq, partneri aktual i koalicionit në Qeverinë greke, Grekët e Pavarur, merr vetëm një për qind, e me atë edhe nuk siguron hyrje në Parlament.

Hulumtimi i mendimit publik i agjencisë "Plus" për televizionin grek "Skaj" ishte bërë mes 14 dhe 16 tetorit, në mbarë territorin e Greqisë, ndërsa përmes telefonit u anketuan 1.355 persona me të drejtë vote.

Ndërkaq, në bisedën e parë me gazetarë pas dorëheqjes, ish-Ministri i Jashtëm grek, Nikos Kocias tha se shpreson që gjithçka të jetë në rregull me Marrëveshjen e Prespës. Ai e cilësoi shkarkimin e tij si të ndershëm dhe kërkoi nga kryeministri, Aleksis Cipras të publikojë dorëheqjen e tij prej 9 faqesh, në mënyrë që të gjithë të kuptojnë arsyet e vërteta pse vendosi të dilte nga ekzekutivi.

Kocias madje tha se nuk ekziston problem me fondet sekrete për çka u akuzua, pasi sipas tij, ai ishte i vetmi ministër në historinë e shtetit grek i cili propozoi ligj që fondet sekrete t'i kontrollojë Kuvendi. (MIA)



Gruevski ka afat 8 ditë që të paraqitet në burg

Shkup, 19 tetor - Aktgjykimi për dy vite burg për ish-kryeministrin Nikolla Gruevski nga Gjykata e Apelit është dorëzuar në Gjykatën Penale, e cila do ta dorëzojë tek gjykatësi kompetent për sanksione, me çka fillon afati prej 8 ditëve në të cilin Gruevski duhet të paraqitet në burg dhe ta vuajë dënimin.

Nikolla Gruevski për vendimin e gjykatësit ka të drejtë anekse, përmes së cilës mund të kërkojë shtyrje të vuajtjes së dënimit në afat prej 3 ditëve. Nëse gjykatësi refuzon aneksen, Gruevski ka të drejtë anekse tek Këshilli prej tre gjykatësve i cili duhet të sjell vendim përfundimtar për shtyrja të dënimit në afat prej 3 ditëve. Nëse Këshilli konfirmon vendimin, atëherë i dënuari duhet të paraqitet në burg, përcjell Telegrafi Maqedoni.

Përndryshe, ish-kryeministri u dënua me dy vite burg efektiv për keqpërdorim të detyrës zyrtare gjatë blerjes së makinës luksoze "Mercedes" në vlerë prej 600 mijë eurove. Gruevski më herët ka deklaruar se do të shfrytëzojë të gjitha mjetet ligjore që ka në dispozicion.

Të burgosurit do ta pastrojnë kopshtin zoologjik të Shkupit

Shkup, 19 tetor - Të burgosurit e burgut në burgun e Shutkës do të bëjnë voluntarizëm te Kopshti zoologjik. Drejtorët e Kopshtit zoologjik dhe Entit ndëshkimor-përmirësues "Shkupi", Gjorgji Galletanovski dhe Gjoko Kotevski, sot nënshkruan memorandum për bashkëpunim.

"Me këtë e fillojmë projektin për risocializimin dhe edukimin e personave të dënuar për vepra



penale më të lehta. Të burgosurit do të voluntuojnë në mirëm-

bajtjen e higjienës, pastrimit, rregullimin dhe renovimin e

strofllave. Kopshti zoologjik është i hapur për bashkëpunim me të gjithë entet shtetërore dhe institucionet", thotë drejtori i Kopshtit zoologjik, Gjorgji Galletanovski.

Nga Kopshti zoologjik shtojëse gjatë muajve të kaluar është rritur numri i qytetarëve që vizitojnë Kopshtin sidomos me ardhjen e dy elefantëve Dunja dhe Daella.

Stërgjyshërit e sllavo maqedonasve nuk kanë jetuar në Maqedoninë e sotme

Shkup, 19 tetor - Në librin "Dituri Shoqërie" të klasës së katërt fillore i shkruar nga historianët Gjorgji Pavllovski, Lubomir Trajkovski, Naum Dimovski dhe Dragi Stavrevski, i lëshuar në përdorim nga "Prosvetno Dello" në vitin 1996 me urdhër të Ministrisë së Arsimit, qartë flitet për prejardhjen e maqedonasve të sotëm.

Ashtu siç e thotë dhe historia botërore, maqedonasit e sotëm nuk kanë asnjë lidhje me maqedonasit antik, e aq më pak me Maqedoninë e dikurshme me të cilën ka udhëhequr Leka i Madh.

Ky libër nuk mund të gjendet

më nëpër vitrinat e librarive në Maqedoni, e aq më pak të mësohet ajo që shkruhet brenda, informon MEDIAL.

"Leka i Madh dhe maqedonasit antik nuk kanë qenë SLLAV dhe kjo është e saktë. Nuk kanë qenë ajo që jemi ne sot", ka thënë akademikun Bllazhe Ristovski.

"E dini çfarë, të orientohet i gjithë patriotizmi i popullit drejt një propagande masive për t'i bindur njerëzit se janë maqedonas antik dhe me kjo të shfrytëzohet për politikë ditore është gabim. Unë shumë mirë e di se kjo përrallë është shumë e mirë për ta



dëgjuar, e di se këtë shumë qytetarë të Maqedonisë dëshirojnë ta dëgjojnë, por unë vlerësoj se kjo është një patriotizëm i ndërtuar mbi themele të paqëndrueshme",

ka thënë nga ana tjetër, Lupço Georgievski, ish-kryeministër i Maqedonisë.

Stërgjyshërit e sllavo maqedonasve nuk kanë jetuar në Ma-

qedoninë e sotme, ku jetojnë maqedonasit pasardhësit e tyre. Në veri-lindje të Gadishullit Ballkanik gjenden malet e larta Karpitet. Pas tyre është rrafshina e madhe e Evropës Lindore, e cila në fakte ka qenë atdheu i vjetër i sllavëve.

Mungesa e tokës pjellore, kushtet e vështira për jetë dhe sulmet nga fiset jo sllave nga lindja i detyruan të shpërngulen në tre drejtime, njëri prej tyre ka qenë dhe Ballkani, ku gjatë vendosjes së tyre në këto anë ata i gjetën vendat autokton ilirët, thrakët, maqedonasit antik, grekët etj.

Avokati i të akuzuarve në rastin "Monstra", Naser Raufi tha se "sot ishim dëshmitarë se rasti "Monstra" nuk është montuar nga ana e MPB-së vetëm më dëshmitarin e mbrojtur dhe automobilin, por edhe me ekspertizën e armës dhe tokës që është shfrytëzuar te liqeni i Smillkovcës".

GJYKIMI PËR "MONSTRËN" PO PËRSËRITET

ËSHTË E DYSHIMTË EKSPERTIZA E ARMËS!



Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 19 tetor - Për shkak të vendimit të Gjykatës Supreme për rigjykimin e rastit "Monstra" e gjithë procedura penale kundër të dyshuarve për vrasjen e pesëfishtë në Liqenin e Smillkovës, duhet të përsëritet. Edhe pse opinioni është në pritje të publikimit të provave të reja nga Prokuroria Speciale Publike, megjithatë një gjë e tillë sipas familjarëve akuzuarve për rastin "Monstra", nuk pritet të ndodhë së shpejti. Duke u mbështetur në dispozitat e vjetra të Ligjit për procedurë penale dhe aktakuzën e ngritur nga Prokuroria për krim të organizuar, prokurorët Trajçe Pelivanov dhe Artan Ajro të premtën kanë prezantuar në seancën ku janë prezantuar rrëfimet e personave ekspert në rastin "Monstra". Punonjësit e MPB-së, respektivisht pjesëtar të Sektori për krim teknik, Snezhana Nikollovska dhe Nexhat Muriç, folën për ekspertizën e dheut që është gjetur te gomat e "Opell Omegës" dhe gëzhojat e armëve me të cilët janë shtënë. Sipas Nikollovskës, dheut ku ka qenë i shtrirë njëri prej të vrarë në Liqenin e Smillkovës përputhet me atë që është gjetur te vetura, për të

cilën Prokuroria pohon se kanë ikur Halil Demiri dhe Afrim Ismailloviq. Personi tjetër ekspert, Nexhat Muriç ka deklaruar se nga vendi i ngjarjes në Liqenin e Smillkovës atyre u janë dorëzuar 13 gëzhoja nga pushkët automatikë dhe 8 (plumba), respektivisht këto të shtëna janë krisur nga dy kallashnikovë dhe një pistoletë. Nga rifillimi i procesit gjyqësor për "Monstrën" e deri më tani pothuajse asgjë e re nuk është thënë, përveç ripërsëritetjet së provave dhe dëshmitariëve. Për këtë arsye avokati Naser Raufi, të premtën u ndal dhe tha se në seanca që pasojnë në mënyrë të

detajuar, do ta kundërshtoi deklaratën e dëshmitarit E-1, i cili së fundmi tha se i ka dëgjuar të shtënat në vendin e ngjarjes. Ndërkohë siç tha pala mbrojtës e të akuzuarve në rastin "Monstra", një deklaratë e tillë nuk është dhënë në gjykimin që u zhvillua gjatë viteve 2013 dhe 2014. Seanca e radhës për "Monstrën", vazhdon me 26 tetor. Avokati i të akuzuarve në rastin "Monstra" Naser Raufi tha se "sot ishim dëshmitarë se rasti "Monstra" nuk është montuar nga ana e MPB-së vetëm më dëshmitarin e mbrojtur dhe automobilin, por edhe me ekspertizën e armës dhe tokës që është shfrytëzuar te

liqeni i Smillkovcës". Ai theksoi se është e dyshimtë që mostrat për ekspertizë, gjegjësisht gëzhojat nuk dihet se kush i ka dorëzuar për ekspertizë në MPB, që bën edhe më të dyshimtë se një nga gëzhojat është gjetur në Belimbegovë, për të cilën ekspertiza vërtetohet se i përgjigjet me ato të Liqenit të Smillkovcës. "Në fotografinë me numër 13, ku ka tri gëzhoja në një vend, nuk është e mundur dy të mos përgjigjen me ato të liqenit të Smillkovës, dhe njëra të përgjigjet. Këtu paraqitet dyshimi se një gëzhojë ka dalë nga depoja e MPB-së dhe e vendosur te të tjerat", tha Raufi.



Nedellkovski akuzohet për racizëm

Shkup, 19 tetor - Propozim për ngritjen e akuzës për përhapjen e materialit racist dhe ksenofobik është dorëzuar përmes një sistemi kompjuterik. Prokuroria publike e Shkupit dhe Gjykata Themelore Shkupi 1, sot ka dorëzuar aktakuzën kundër një personi për veprën penale "shpërndarje të materialit racist dhe ksenofobik nëpërmjet sistemit kompjuterik", në bazë të nenit 394 alineja 1 të Kodit Penal. Bëhet fjalë për gazetarin kontraverz Milenko Nedellkovski. Personi akuzohet se më datë 24.7.2018, nëpërmjet një sistemi kompjuterik, ka përhapur materiale ksenofobike duke promovuar urrejtje kundër një grupi në baza etnike. Gjegjësisht, i dyshuari si një figurë publike-gazetar nga profili i tij publik në një rrjet social publikoi një koment mbi zjarrin në gadishullin grek të Atikës, në të cilën ka pasur edhe viktima në njerëz. Në të njëjtën kohë, koment i nxitur ndaj një grup të caktuar etnik-grekë, të cilët u prekën nga zjarri shkatërrues. Për këtë krim, sipas Kodit Penal, parashihet dënimi me burg prej një deri në pesë vjet. Gjatë hetimit, prokurori publik dhe Ministria e Punëve të Brendshme - Sektori i krimin kibernetik dhe mjeko-ligjor, siguroi një dokument digjital të detajuar në lidhje me veprimtarinë dhe profilin e përdoruesit në këtë rast të dyshuarit në rrjetin social dhe prova të tjera. Sipas komunikatës, i dyshuari nuk dha deklaratë në prokurorinë publike sepse nuk ishte i pranishëm në adresën e tij në mënyrë që të pranonte ftesën. Përveç kësaj, prokuroria ka pasur qasje në komentet e njerëzve të tjerë në tekstin e botuar të të dyshuarit, por vlerësohet se aspekti i drejtësisë penale ka baza për të vepruar vetëm kundër të dyshuarit, sepse statusi profesional i tij ka ndikuar në rrjetin social dhe ka nxitur reagime në publik. Prokuroria, si një organ që ndjek kryerësit e veprave penale vlerëson mundësitë ligjore për veprim, faktet dhe provat e siguruar për çdo vepër në veçanti dhe justifikimin shoqëror për veprimet e prokurorisë publike, në veçanti duke u kujdesur që të mos pengojë lirinë e shprehjes.

Promovohen 26 nënkolonelë

Shkup, 19 tetor - Suksesi i Armatës së Republikës së Maqedonisë nga ekzistimi i saj 27 vjeçar si shtet për të cilin u sakrifkuan mijëra pjesëtarë të ushtrisë tonë duhet të kurorëzohet me suksesin e quajtur Maqedonia anëtarja e 30-të e NATO-s. Këtë sot e theksoi ministrja e Mbrojtjes, Radmila Shekerinska në promovimin e klasës së 18-të të nënkolonelëve dhe dhënien e betimit të kadetëve të rinj nga klasa e 22-të e Akademisë ushtarake "Gjeneral Mihajlo Apostolloski". Betim solemn dhanë 33 kadetë prej të cilëve 25 nga Maqedonia, katër nga Bosnjë e Hercegovina, tre nga Mali i Zi dhe një nga Kosova. Njëkohësisht si nënkolonel u promovuan 26 kadetë nga Maqedonia, dhe dy nga Mali i Zi ndërsa një nga Kosova. Përfitimet e anëtarësimit tonë në NATO, sipas ministres, të parët do t'i ndajnë pikërisht pjesëtarët e ARM-së. Pikërisht për këtë shtoi ajo, këtë vit është rritur Buxheti i mbrojtjes për 15 për qind. Ministrja Shekerinska tha se posaçërisht është krenare që shtatë nga nënkolonelët e rinj janë femra dhe ajo se sot betim kanë dhënë 10 pjesëtarë të gjinisë më të butë./MIA

Universiteti "Nënë Tereza" bëhet me park teknologjik

Shkup, 19 tetor - Park teknologjik do të funksionojë në Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup, me çka ky institucion i lartë arsimor do të fitojë mjete nga Ministria e Ekonomisë. Marrëveshja për bashkëfinancimin e projektit, që është masë e Programit për konkurrencë, inovacione dhe sipërmarrësi në vitin 2018 sot e ka nënshkruar rektori Aziz Pollozhani dhe ministri Kreshnik Bekteshi. Bekteshi ka thënë se masa është në pajtueshmëri me thirrjen e publikuar me të cilin bashkëfinancohet projekti për parkun teknologjik në kuadër të Universiteteve në Maqedoni edhe atë 75 për qind nga mjetet e nevojshme, por jo më shumë se 1.5 milionë denarë. "Pas kësaj thirrje arriti vetëm një aplikim - nga Universiteti 'Nënë Tereza'. Ajo është shqyrtuar nga Komisioni i cili solli vendim se aplikuesi i përmbush kushtet dhe e fiton mbështetjen financiare", ka thënë Bekteshi në nënshkrimin e Marrëveshjes ku siç ka shtuar "pret së shpejti të fil-



lojë realizimi i projektit". Qëllimi i hapjes së parqeve teknologjike është transferimi i teknologjive, lidhja e kompanive me bashkësinë akademike dhe përgatitjen e studentëve në inkuadrimitin në biznesin real, promovimi i inovacioneve, me qëllim rritja e fuqisë ekonomike të vendit. "Për suksesin e kësaj ideje dhe themelimin e parkut teknologjik janë meritore profesorët e Fakultetit Teknik dhe Teknologjik, por para së gjithash Ministria e Ekonomisë që në projektin tonë njohu angazhim serioz në realizimin e saj dhe mbështetjen financiare", ka thënë rektori Pollozhani./MIA

FONDE TË VARFRA E KUSHTET E KËQIJA

BIBLIOTEKAT NË KRIZËN MË TË MADHE

Kushtet e këqija ku operojnë pjesa më e madhe e biblioteka në vend, fondet e varfra me tituj kanë sjellë rezultatet e veta, duke bërë që anëtarësimi të zbrësë në nivele të frikshme. Vetëm gjatë viteve të fundit numri ka rënë nga një mijë anëtarë mesatarisht në çdo bibliotekë në vetëm 754 anëtarë. Edhe pse në një prej raporteve të Ministrisë së Kulturës konstatohet kjo situatë e keqe, mungesa e investimeve, mangësi në fondin e librave..., edhe për këtë vit buxheti i akorduar nga ky institucion nuk ka ndonjë dallim të madh me vitet paraardhëse



zbrësë në nivele të frikshme. Vetëm gjatë dhjetë viteve të fundit numri ka rënë nga një mijë anëtarë mesatarisht në çdo bibliotekë në vetëm 754 anëtarë. Gjithsej numërohen 51 biblioteka në të gjithë vendin, me një fond bibliotekar që nuk arrin as deri në dy milionë ekzemplarë. Sipas të evidencave zyrtare numri më i madh i anëtarësimeve është në bibliotekat për arsimin e lartë, më pak bibliotekat publike dhe një numër shumë i vogël në bibliotekat që janë pjesë e institucioneve nacionale. Pjesa më e madhe e bibliotekave (34) janë në kompetenca të Ministrisë së Kulturës dhe një pjesë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Në një prej raporteve të Ministrisë së Kulturës lidhur me veprimtarinë bibliotekare konstatohet se gjatë kësaj periudhe dhjetë vjeçare në këtë sektor inve-

stimet kanë qenë minimale, pjesa më e madhe e bibliotekave janë të vendosura në objekte jofunksionale, që nuk janë ndërtuar sipas standardeve, madje duke përfshirë këtu edhe objektin më të ri, Bibliotekën nacionale. Po ashtu neglizhenca e vetë bibliotekave kanë qenë evidente, sidomos në mbrojtjen e fondeve, kërkesat për ekzemplarin e detyrueshëm, e të tjera. Sipas Ministrisë së Kulturës pritet të çelen biblioteka të reja në qytete si Tetovë, ku prej shumë vitesh është në ndërtim e sipër kompleksi Biblioteka dhe Teatri, në Ohër, ndërsa pranë qendrave të kulturës në qytete si në Gostivar, Strugë, Kërçovë e të tjera të ngrihen biblioteka publike.

BIE FONDI I LIBRAVE

Por nga ana tjetër me buxhetin e këtij viti Ministria e Kulturës ka vënë në dispozicion një fond që

nuk dallon shumë nga vitet paraardhëse, gjithsej 88 milionë denarësh, ose vetëm katër për qind më i madh se një vit më parë. Sa i takon bibliotekave publike, sidomos ato në pjesën shqiptare, problemet janë nga më të ndryshmet. Nëse disa prej tyre funksionojnë në kushte më normale, me salla adekuate leximi, fondi i librave është më i vogël, në disa të tjera, si në Bibliotekën e Tetovës (një prej bibliotekave më të mëdha në vend me mbi 150 mijë tituj) hapësirat e leximit, arkiva dhe kushtet ku ruhen librat janë jashtë standardeve. Si biblioteka me fondin më të pasur bibliotekar, si libra dhe broshura, gazeta, revista, dorëshkrime..., është ajo nacionale. Edhe bibliotekat publike (ish popullore) numërojnë po ashtu më shumë ekzemplarë, edhe pse ky fond është shumë më i vogël sesa vite më parë. Për shembull, në fillim të

viteve nëntëdhjetë numëroreshin 138 biblioteka popullore, sot numri i tyre është thuhetse tre herë më i vogël, ndërsa ekzemplarët që gjenden në to mezi arrijnë në dy milionë. Në vite po ashtu ka rënë edhe tirazhi i librave, apo broshurave që botohen. Nëse më parë tirazhi e tejkalonte shifrën prej katër milionë, vitet e fundit tirazhi i librave dhe broshurave arrin në 542 mijë.

AS BIBLIOTEKAT, AS TEATROT, TË GJITHË SHKOJNË NË KINEMA

Preferencat për të kaluar kohën e lirë shihen në frekuentimin e institucioneve të ndryshme të kulturës, rekreacionit..., ose numrin e vizitorëve që evidentohen në vit. Kinematë (gjithsej 14 të tilla) frekuentohen në vit mesatarisht nga rreth 33.650 vizitorë. Pas tyre vijnë muzetë (gjithsej 28 muze) që kanë shënuar mesatarisht 1700 vizitorë në vit. Shifrat kanë qenë dyfish më të larta gjatë periudhës 2009-2013, pas ndërtimit të disa muzeve në qendër të Shkupit. Në teatro (gjithsej 17) mesatarja e frekuentimit brenda një viti është 1400 persona (238 mijë vizitorë në total). Ajo që bie në sy është se pavarësisht se numri i shfaqjeve është rritur gjatë viteve të fundit (nga 900 në rreth 1300 shfaqje në vit) numri i biletave të arkëtuara është thuhetse i njëjtë. Gjatë dhjetë viteve të fundit numri i shfaqjeve është rritur me 51 për qind, ndërsa i publikut vetëm me 2.6 për qind.

Koha Evis HALILI

Shkup, 19 tetor - Përveç reduktimit të numrit të librarive, bibliotekave e ekzemplarëve në to prej më shumë dy dekadash, interesimi gjithnjë e më i vogël ndaj librit po reflektohet me uljen drastike të anëtarësimeve në ato biblioteka ekzistuese. Kushtet e këqija ku operojnë pjesa më e madhe e biblioteka në vend, fondet e varfra me tituj kanë sjellë rezultatet e veta, duke bërë që anëtarësimi të

Reforma sociale prezantohet para ekspertëve në Strasburg



Shkup, 19 tetor - Ministria e Punës dhe Politikës Sociale sot e prezantoi reformën në mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve në Maqedoni. Nevoja për reformën si dhe efektet e pritura nga zbatimi i saj që duhet të fillojë nga viti i ardhshëm, Carovska e elaboroi para ekspertëve nga 42 vende-anëtare të AD HOK Komitetit për romë. "Me reformën

vendosim program për të ardhura të garantuara minimale, që do të mundësojë mbështetje financiare për të gjithë personat që jetojnë nën linjën e varfërisë. Qëllimi i kësaj të ardhure është që t'u sigurojmë mjete të mjaftueshme për jetë dinjitoze, t'i inkuadrojmë në shoqëri, por edhe të punojmë në aftësimin e tyre për punësim të përhershëm. Luftojmë edhe

kundër varfërisë fëmijërore, për shkak se çdo fëmijë për ne është i rëndësishëm. Vendosim shtesë për fëmijë dhe për arsim, ndërsa të drejtë për këto kompensime përveç shfrytëzuesit e të ardhurave të garantuara minimale do të kenë edhe amvisëritë me të ardhura minimale", tha ministrja Carovska.

Ajo, siç njoftoi Ministria, në Strasburg kishte takim pune me zëvendës-sekretaren e përgjithshme të Këshillit të Evropës Gabriela Bataini Dragoni. Në takim është biseduar për aktivitetet e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale të lidhura me integrimin e romëve, si dhe për pjesën më të madhe të rregullativave ligjore në kompetencë të MPPS-së.

Bataini Dragoni i përshëndeti përpjekjet që Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale i bën për përmirësim të mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve dhe shprehu mbështetje për ndihmë teknike për skrinng procesin në pjesën e çështjeve sociale.



Gjergj Dedaj edhe zyrtarisht ambasador i Kosovës në Maqedoni

Lajmin se presidenti maqedonas Gjorge Ivanov ka nënshkruar dekretin për misionin diplomatik të Dedajt në Shkup e ka bërë të ditur ky i fundit me anë të një postimi në Facebook.

"Do jam ambasador i devotshëm dhe dinjitoz i Kosovës në Maqedoni! Falënderoj presidentin Thaçi, për dekretimin tim, ambasador i jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Kosovës ne Shkup, si dhe një falënderim për Presidentin e Republikës së Maqedonisë Ivanov, për nënshkrimin e dekretimit tim, në këtë mision të rëndësishëm shtetëror", ka shkruar ai.

Kriza ekonomike ka bërë që shumë infermierë të jenë të detyruar të kërkojnë punë në vende të tjera, qoftë brenda vendit apo jashtë profesionit të tyre. Pjesa rurale e ka më të vështirë, por nuk përjashtohet edhe ajo urbane. Mungesa e infermierëve mund të jetë kritike. Shqetësuese është se influenza e kësaj mungese ndikon në qasjen, sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore.

Koha

Delvina KËRLUKU

Shkup, 19 tetor – Mungesa e infermierëve ballafaqohet me rritjen e kërkesës për kujdes shëndetësor. Progresi drejt sigurimit të përgjithshëm shëndetësor pengohet nga mungesa e personelit shëndetësor në numra të duhur, në vendin e duhur dhe me aftësitë e duhura për të ofruar shërbime cilësore për të gjithë popullsinë. Maqedonia ka mungesë të madhe të punonjësve shëndetësor, për shkak të ikjes së tyre jashtë vendi, veçmas infermierëve, por nuk përjashtohet edhe mundësia e rënies ekonomike, ku pagat e tyre nuk janë të mjaftueshme për ekzistencë.

PJESA RURALE E KA MË TË VËSHTIRË

Kriza ekonomike ka bërë që shumë infermierë të jenë të detyruar të kërkojnë punë në vende të tjera, qoftë brenda vendit apo jashtë profesionit të tyre. Pjesa rurale e ka më të vështirë, por nuk përjashtohet edhe ajo urbane. Mungesa e infermierëve mund të jetë kritike, ndërsa ata ofrojnë kujdesin primar. Shqetësuese është se influenza e kësaj mungese ndikon në qasjen, sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore. Pra, ka efekte negative në mungesë të infermierëve tek pacientët. Infermierët janë forcë vitale për sigurimin e kujdesit cilësor në kohë të vështira duke ndihmuar sistemin të jetë më efektiv dhe më

RËNIA E NUMRIT TË INFERMIERËVE

PASOJA NË KUJDESIN E PACIENTIT



efikas në kujdes.

Motra medicinale Nora L. e sapo diplomuar, i është drejtuar një qendre për ndërmjetësim dhe punësim në Gjermani. Ajo thotë se kushtet më të mira të punës kanë bërë që të mendojë që të largohet edhe pse është në moshë shumë të re. "Të gjithë shtetasit e këtij vendi janë të vetëdijshëm se sa e madhe është papunësia, sidomos për ata që janë të diplomuar. Vetë fakti që gjermanët neve na mundësojnë gradualisht të përparojmë dhe na japin mundësi më të mëdha që i kemi këtu, atëherë është normal që si unë ashtu edhe të gjithë të tjerët do të kishim konkurrar", tha motra Nora, për gazetën KOHA. Si shumë spitale të vendit edhe Klinika për fëmijë, në Shkup, ballafaqohet me probleme të ndryshme dhe mungesë të kuadrit. Nga ministria e shëndetësisë paralajmërojnë se do të bëhen punësime të reja të motrave medicinale. "Planifikojmë të bëjmë pranime të reja edhe përkundër numrit të madh të motrave medicinale që veçmë janë të pranuar në këtë Klinikë të fëmijëve, poashtu do të investojmë në edukimin dhe trajnimin e tyre", thonë nga Ministria e Shëndetësisë, njofton KOHA. Unioni i Infermiere-

ve thotë se ikja e personelit mjekësor po ndodh kryesisht për shkak të kushteve të punës dhe rrogave të ulëta. "Në Maqedoni ndonjë profesion tjetër nuk ka përpos stafit mjekësor që për çdo ditë mbesin pa punë, siç janë infermieret tona nga koncensionerët. Nuk ka ditë që nga çdo qytet nuk lajmërohen për të treguar se kanë mbetur pa punë. Shumica prej tyre kur marrin informacion se do të mbyllin ordinanca, në kohë njoftojnë Ministrinë e Shëndetësisë, por ato u kthejnë përgjigje më atë që nuk është mbyllur ordinanca dhe nuk kanë bazë mbi të cilën duhet t'u kthejnë në Shtëpitë e Shëndetit. Kur mbyllën ordinancat, përfundojnë afatet e ligjit dhe ju thonë që kanë kaluar afatet mbi të cilët mund të kthehen në punë"- thekson Gordana Beshliovska, kryetare e Unionit të Infermiereve.

MOSHA, PROBLEM PËR PUNËSIM

Edhe pse janë hapur konkurse në disa spitale të vendit, shumë nga infermierët nuk kanë interesim ose edhe qasje për punësim. Nga Unioni i Infermiereve thonë se infermieret e pa punë kanë aplikuar në çdo konkurs në Shtëpitë e Shëndetit dhe ambulancat tjera por thek-

sojnë se nuk janë konkurrentë për shkak të moshës së tyre. Motra medicinale nga Kumanova Jagoda Mladenovska është viktimë, meqë ka mbetur pa punë në moshë të thyer, pasi është mbyllur ordinanca private ku ajo ka punuar. "Që nga 15 marsi kam mbetur pa punë sepse mjeku ka dalë në pension dhe ambulanca mbyllet. Tani jam tepriçë teknologjike dhe pa punë, me 32 vjet përvojë pune, prej të cilëve 20 vjet në shtetërore dhe 12 në ambulancë private", tha motra medicinale. Nga Ministria e Shëndetësisë thonë që me ndryshimet e Ligjit për Mbrojtje Shëndetësore, të gjitha infermierët do të rikthehen sërish në Shtëpitë e Shëndetit. Niveli i stafit të infermierëve dhe mjedisit të punës kanë pasojë të drejtpërdrejta në kujdesin e pacientit.

Rënia e nivelit të stafit infermierëve në mjedisin e punës kanë pasojë të drejtpërdrejta në kujdesin e pacientit. Kujdesi shëndetësor viteve të fundit është rritur, për shkak të epidemive, virozëve të ndryshme, para së gjithash e nxitur nga barra e rëndë dhe në rritje të sëmundjeve të transmetueshme, duke përfshirë çrregullimet e shëndetit mendor, shoqëritë në plakje, etj.



Mushkonjë aziatike-tigër në vendin tonë

Shkup, 19 tetor - Një mushkonjë aziatike-tigër është vërejtur në vendin tonë. Kompetentët sigurojnë se po bëhet shënim në hartë i gjithë territorit për të përcaktuar se ku është zgjeruar ky insekt i rrezikshëm, nga pickimi i të cilit mund të ndodhin shumë komplikime shëndetësore. Deri më sot, asnjë qytetar nuk ka kërkuar ndërhyrje mjekësore në lidhje me disa prej sëmundjeve që mbart kjo mushkonjë. Insektet e tilla tashmë janë vërejtur në disa komuna të Shkupit, por edhe në disa pjesë në jug të vendit, në Bogdanci dhe Dojran. Simptomat e pickimit të mushkonjës tigër janë skuqja e lëkurës, ënjtje, plogështi, dhimbje koke, mundim dhe rritje e temperaturës së trupit. Ajo shumohet në sasi shumë të vogël të ujit, madje edhe në një gotë apo tas për ujitjen e luleve, në goma të ndenjura në ujëra. Kjo mushkonjë e kalon në lehtësi periudhën e dimrit dhe bëhet aktive nga muaji mars, aktivitetin më të madh e shfaq në qershor, korrik dhe gusht "- u shpreh Zharko Karaxhovski nga Instituti për shëndet publik.

Nxënësit vizituan Komunën e Gostivarit

Nxënësit e klasës së katërt pranë Shkollës Fillore Komonale "Goce Dellçev" – Gostivar, të shoqëruar nga mësuesja e tyre Sevim Sulo, ishin sot për vizitë në Komunën e Gostivarit, për tu njoftuar me mënyrën e funksionimit të pushtetit lokal dhe shërbimet të cilat ua ofron administrata komunale qytetarëve të Gostivarit, njofton Shërbimi për informim.

Gjatë vizitës ata takuan kryetarin e komunës Arben Taravari dhe bashkëpunëtorët e tij si dhe vizituan sallën e Këshillit të komunës dhe ambientet ku kryejnë detyrat administratorët komunalë.

"Pata kënaqësinë të takohesha me nxënësit e shkollës fillore "Goce Dellçev". Takimi me fëmijët është një leksion i çmuar çiltërsie dhe pozitiviteti përveçse një terapi e

shkëlqyer.

Tashmë kemi marrë shumë këshilla dhe plot energji për punë, ndaj do të jemi më të vendosur që të punojmë për kushte sa më të mira në këtë shkollë. Këta fëmijë të mrekullueshëm duhet të mbeten në Gostivar, detyra jonë është tu sigurojmë atyre të ardhmen", thotë kryetari i komunës Arben Taravari.





REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 230/2018

për punësimin e 2 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Qeverinë e Republikës së Maqedonisë – Sekretariati gjeneral “për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor më i ri për përkrahje të politikave ekonomike, Njësia për politika aktuale ekonomike, Sektori për politika ekonomike, reforma strukturore dhe investime

1 realizues(ë)

- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30
Rroga neto: 20.987,00 denarë

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat Ekonomike, Shkencat Juridike, Shkencat e Organizimit dhe administrim (menaxhment)
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premtë
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

2. UPR0101V03000 Bashkëpunëtor për konkurrencë me komunitetin ndërkombëtar, Njësia për përcjellje dhe analizë të strategjive shtetërore, konkurrencë, klimë afariste dhe koordinim të projekteve të ndihmuara nga komuniteti ndërkombëtar, Sektori për politika ekonomike, reforma strukturore dhe investime

1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat Ekonomike, Shkencat Juridike, Shkencat e Organizimit dhe administrim (menaxhment)
- së paku 1 (një) vit përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premtë
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30
Rroga neto: 22.500,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpallje publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai inçizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 229/2018

për punësimin e 2 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komunën e Lozovës “për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101V01000 Këshilltar për administrim të të ardhurave, Njësia për tatim të pronës

1 realizues(ë)

- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
Rroga neto: 25.022,00 denarë

- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat Ekonomike
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premtë
- Orët javore të punës 40

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

2. UPR0101G02000 Referent i lartë - Përmbartues tatimor, Njësia për tatim të pronës

1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VA ose niveli i kualifikimeve IV, sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose së paku arsim të lartë ose të mesëm, drejtimi Gjinnaz, Ekonomi ose Teknikë ose drejtim Teknik i lartë
- së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premtë
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
Rroga neto: 15.917,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpallje publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai inçizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

DIGJITALIZIMI NË MAQEDONI

MUNGON AMBIENTI DHE POLITIKAT SHTETËRORE

Ekonomia e Maqedonisë po bën hapat e para drejt digjitalizimit dhe akoma e pret shumë punë në këtë drejtim. Me fjalë bizneset në vend akoma pak përdorin teknologjinë digjitale në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve në ekonomi



Koha Fisnik Pasholli

Shkup, 19 shtator – Ekonomia e Maqedonisë po bën hapat e para drejt digjitalizimit dhe akoma e pret shumë punë në këtë drejtim. Akoma ngec zbatimin e drejtpërdrejt të zgjidhjeve moderne të teknologjisë informatike në punën e përditshme të bizneseve. Me fjalë bizneset në vend akoma pak përdorin teknologjinë digjitale në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve në ekonomi. Pak ndiqen shembujt e tregtisë elektronike si “Ali Baba”, apo vetëm një për qind e bizneseve të Maqedonisë shesin në internet. Ajo që është praktikë e përditshme në botë, akoma duhet të praktikohet nga kompanitë vendore që të bëhen më efikase dhe më fitimprurëse në punën e tyre, duke zvogëluar harxhimet për marketing dhe distribuim. Megjithatë, që kompanitë vendore të orientohen më shumë ndaj digjitalizimit të punës së tyre nevojitet edhe zhvillimi më i madh i industrisë dhe rritje e eksportit të prodhimeve dhe shërbimeve. Kjo ndër të tjerash u theksua në ditën e hapur që e orga-

nizoi GS1 Maqedoni.

Kompanitë vendore në Maqedoni duhet të fokusohen ndaj identitetit të prodhimeve dhe të dhënave të tyre që do tu ndihmojë të jenë të dukshme në tregjet botërore. Digjitalizimi nënkupton uljen e harxhimeve në aspekte të ndryshme në varësi prej kompanive, për-

mes tregtisë tej-kufitare dhe doganës, magazinimit efikase dhe logjistikës”, thotë shefi i zyrës globale të GS1 Robert Bajdemen.

Kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë, Branko Azeski, thotë se edhe tani po implementojmë teknologjitë më të reja digjitale, megjithatë sipas tij, shtrihet çë-

shtja se sa me të vërtetë edhe kemi një ambient që përdorimi i tyre të sjellë zhvillim ekonomik.

“A kemi kompani që do tu shërbejnë teknologjitë e tilla. Ne pohojmë se kemi, por ekzistojnë më shumë dobësi që duhet të eliminohe. Kemi humbur 20 apo 30 vite duke u ballafaquar me sfidat the-

melore në ekonomi, ndërsa tani këtë kohë duhet ta kompensojmë. Njëherazi nuk duhet që të shfrytëzohet parimin e rrënimin të vazhdueshëm dhe ndërtimin nga e para të gjërave për shkak se kjo paraqet një formulë dështuese”, shton më tej Azeski.

Sipas tij, në vend kemi shembuj të kompanive që punojnë sipas trendeve më moderne teknologjike, por megjithatë për diçka më shumë na mungon ambienti dhe politikat shtetërore.

Sipas Sergej Zafirovski nga “Insajder ID”, ne mendojmë se përdorim teknologjinë digjitale, por në të vërtetë punojnë me diçka që është e vjetër 20 deri 25 vjet. Digjitalizimi ka ardhur, por megjithatë ne frikësohemi nga ndryshimet shton më tej ai. Duhet të kuptojmë se digjitalizimi dhe inovacionet janë përparësia konkurruese e ekonomisë së Maqedonisë që mund ti përgatisë dhe aftësojë ato për eksport.

Sipas drejtoreshës së GS1 Maqedoni, Slagajna Milutinoviç ekonomia e Maqedonisë është në fillimin e digjitalizimit të saj.

“Duhet të risim vetëdijen dhe të kuptojmë se ky proces, nuk nënkupton thjesht vetëm blerjen onlajn, apo posedimin e një ueb faqe, por paraqet një sistem shumë më të thellë të zgjedhjeve integruese në proceset teknologjike”, shton ajo. Sipas Milutinoviç në të ardhmen sfidë më të madhe në këtë drejtim do të paraqet ndryshimin e mentalitetit apo mënyrës së të menduarit të njerëzve. Ndryshe, tregu onlajn në Maqedoni është i vlefshëm vetëm 140 milion dollarë, ndërsa oferta nuk josh më shumë blerësit.

DIGJITALIZIMI NË EKONOMI

Digjitalizimi i punëve, ndryshe i njohur gjerësisht dhe me emrin Industria 4.0, në thelb i referohet përdorimit të teknologjisë digjitale në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve në ekonomi. Kjo teknologji e re, e cila ka pak vite që ka filluar përdorimin e saj, do të mundësojë jo vetëm rritjen e shpejtësisë dhe saktësisë së shërbimeve, por pritet të ndryshojë rrënjësisht dhe tregjet në ekonomi, sidomos tregun e burimeve njerëzore. Gjermania ka qenë vendi i parë, i cili ka promovuar digjitalizimin e ekonomisë që në vitin 2011 nëpërmjet një platforme ekonomike. Me këtë promovim, ky vend u bë i pari që rriti digjitalizimin e ekonomisë nëpërmjet ndërlikohjes së linjave të prodhimit. Gjermania është pranuar gjerësisht si një pioniere në revolucionin e katërt industrial dhe po merr një rol udhëheqës në ndërtimin e standardeve dhe normave ndërkombëtare. Duke njohur nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar,

Gjermania po punon me vendet e tjera për të zhvilluar dhe miratuar standardet dhe normat globale, që nxisin ndërveprimin dhe rrjedhat e të dhënave. Shumë vende të tjera janë rreshtuar në vijën e parë të promovimit të këtij revolucioni të ri industrial me përfitime të mëdha ekonomike. Republika Çeke, Zvicra, Anglia, Franca, Kina, Japonia, Koreja e Jugut, SHBA, etj. kanë shpallur programet e tyre afatmesme të zhvillimit në të cilat një vend gjithnjë e më të madh zë digjitalizimi i prodhimit. Janë 25 vende nga Evropa, Amerika e Veriut, Azia Lindore dhe Paqësori të cilët prodhojnë mbi 75 për qind të prodhimit në nivel global. Sot ata janë, gjithashtu, të pozicionuar mirë për të ardhmen e prodhimit. Shumë prej këtyre vendeve janë në ballë të projektimit, testimit dhe pionierizimit të teknologjive në zhvillim dhe kanë zhvilluar strategji të drejtuara nga qeveria për të përfituar nga revolucioni i katërt industrial.

QYTETARËT ME MBI 3 MILIARDË EURO KURSIME NËPËR BANKA

Vlera e depozitave të klientëve në dhjetë bankat komerciale në Kosovës, deri në tetor të këtij viti ka arritur në mbi 3 miliardë euro, ka bërë të ditur Banka Qendrore e Kosovës.



Nga kjo shumë, më shumë se 2.2 miliardë euro janë para të kursyera nga ekonomitë familjare, derisa ndërmarrjet kanë të depozituara mbi 750 milionë euro. Vlera e valutave të tjera të kursyera nga qytetarët e Kosovës arrin shumën e 154 milionë euro.

Vlera e depozitave e tejkalon edhe shumën e kredive të përgjithshme në nivel vendi.

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, vlera e kredi-

ve ka arritur në mbi 2.6 miliardë euro, ku ekonomitë familjare kanë rreth 1 miliardë euro kredi në bankat komerciale, derisa ndërmarrjet kanë mbi 1.6 miliardë euro.

Kjo shumë e madhe e mjeteve të kursyera në raport me kreditet nga ekspertët të fushës dhe përfaqësues të bizneseve shpjegohet në mënyra të ndryshme.

Eksperti i çështjeve financiare, Milazim Abazi thotë për Radion Evropa e Lirë se vlera e depozitave do të duhej të ishte në raport me

kredidhënien.

“Depozitat po rriten shumë më ngadalë se sa kreditet. Qytetarët më shumë po kanë kërkesa kreditore se sa janë mundësitë e bankave për të dhënë kredi për shkak të rritjes së ngadalshme të depozitave apo kursimeve. Derisa, kursimet janë rritur 6 për qind në vit kërkesat për kredi janë rritur rreth 15 për qind”, thekson Abazi.

Sipas tij, Kosova në krahasim me vendet e rajonit ka nivelin më të ulët të depozitave për kokë banori.

Ai shton se bankat komerciale do të duhej të rrisnin interesin në depozita në mënyrë që qytetarët të arrijnë të kursejnë edhe më shumë.

“Ulja e interesit në depozita ka ndikuar që të mos rriten me ritmin e duhur. Nëse bankat i rrisin interesin në kursime qytetarët do të kursenin më shumë dhe kjo më pas do të mundësonte që bankat të rrisin potencial për kredidhënie”, thekson Abazi.

Sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës, interesi për depozitat është vetëm 1.5 për qind, derisa kamatat për kredi sillen nga 6 deri në 7.7 për qind, varësisht nga lloji i kredisë dhe banka komerciale.

Agim Shahini nga Aleanca Kosovare e Biznesit thekson se është e dyshimt nga vjen kjo rritje e depozitave në një vend ku papunësia dhe varfëria është e lartë.

“Ekonomia jo ligjore, korrupsio-

ni dhe çrregullimet në një treg financiar të pakontrolluar rritin depozitat, mjete këto të cilat vinë në formë të ndryshme në llogaritë bankare të individëve të caktuar dhe të bizneseve. Në Kosovë flasim që ka papunësi e varfëri, por këto depozita falsin diçka tjetër”, thotë Shahini.

Shuma e mjeteve materiale të kursyera të qytetarëve në bankat komerciale që veprojnë në Kosovë, është më e madhe se sa buxheti i përgjithshëm i vendit.

Përderisa buxheti për vitin 2018, kap shifrën e mbi 1.8 miliardë euro, depozitat e qytetarëve janë mbi 3 miliardë euro.

Përgjegjës për sigurimin e depozitave është Fondi i Sigurimeve të Depozitave të Kosovës. Limiti i tanishëm i sigurimit të depozitave për një depozitor, person fizik apo juridik, në një bankë është 5 mijë euro.

(Pa)fajësia dhe kutet



Nga
Daut DAUTI

NDËRKMBËZAT: më pyetën nga një portal ç'mendoj për letren e Ues Miçelit drejtuar liderit të VMRO-së, një ditë pas. I peshova disa veprime të fundit, si faljen e mundshme, ose pajtimin që ofron Zaevi, dhe këtu letra e zëvendës-sekretarit amerikan m'u duk si ajo shtysë "e duhur" që gjërat të rrumbullakohen. Por, si duket, Maqedonia ka hyrë në një "fotofinish" maratone, ku njëri nga vrapuesit, në vend se të kalojë në cak për triumf, ndalet dhe u ve ndërkombëzat edhe të tjerëve! Që finishi të pësojë debakël.

Në "profecinë" time për efektin e letres së Ues Miçelit, parashikova dy gjëra. Një, se VMRO-ja - për shkak të gjenit destruktiv që ia mvëshin gjithnjë e më shpesh që ka pasur në histori, me shumë zigzage, shpesh në dëm të kauzës për të cilën thuhet se ka luftuar- thashë se mund t'i mbetet besnik pozicionit kundër Marrëveshjes së Prespës. Si argument për këtë mora deklaratimet kategorike të Mickovskit dhe të bashkëpartiakëve të tij, pas të cilave nuk kanë lënë hapësirë manovrimi për kthim prapa. Dhe dy, duke i pasur parasysh manovrimet para referendumit, sidomos tash pas ofertës së Zaevit për pajtim, të marrë një qëndrim "as mish, as peshk", mundësia tjetër është që të dalë Mickovski e të thotë "ua lë deputetëve në ndërgjegjen e tyre të vendosin". Pengimi i Maqedoninë në rrugën euroatlantike, do të jetë vetëm një episodë më tepër në historinë e këtij subjekti që të gjenet në periferinë e ngjarjeve historike. Kjo forcë politike e ushtarake, në kohën e konferencave të mëdha për krijimin e shteteve të reja në dy dekadat e shekullit 20-të, ishte



"Presumpcioni i pafajësisë" nuk është i vetmi me të cilin ndeshemi, por dhe kuti që e imponon praktika në një shoqëri. A kemi kut të njëjtë? Ndaj kryeministrit Zaev zhvillohej proces gjyqësor që para se ta merrte mandatin, dhe ai proces ka vazhduar edhe pasi u bë kryeministër! Pse nuk kërkohet dje nga Zaevi, ajo që kërkohet sot nga ministri shqiptar i qeverisë së tij?

gjithkund, por jo edhe në konferencat ndërkombëtare ku vendosej fati i popujve (Mbase duke u marrë me qërim të brendshëm hesapësh!). Gjatë Luftës së Dytë Botërore, poash-tu nuk lëvizti as me gishtin e vogël që ta organizojë kryengritjen kundër okupatorëve (këtë e shfrytëzuan komunistët), kurse në ndërtimin e Maqedonisë demokratike, u paraqit si forcë anakronike me platformë nacionaliste, që për shumëçka ia vësh-tirësoi vendit shumë procese të brendshme por dhe në suaza të pozicionimit ndërkombëtar të vendit.

(Këtu po e ndërpres tekstin rreth kësaj çështjeje, sepse do të isha në shpërputhje në kohë me dinamikën e ngjarjeve, sepse kur e dorëzoja tekstin për botim, pritej votimi i ndryshimeve kushtetuese në Parlament dhe është e pamundur të jepej ndonjë

koment përfundimtar pa e ditur epilogun.)

PARIMI KA NJË KUT: Këto ditë e ndien një "lehtësim" dhe një satisfaksion të gjithë ata që ka herë kanë pritur nga Prokuroria Speciale të dyshojë një figurë "të lartë" të BDI-së. Dhe Prokuroria sikur të kishte dëgjuar zërin e tyre, doli me një emër, për të cilin një herë kishte thënë se nuk ka lëndë për të. Personi i dyshuar u deklarua i pafajshëm. Domethënë, një e vërtetë e PSP-së, e cila tek duhet ta dëshmojë fajësinë, dhe një e vërtetë e të dyshuarit që mendon se është i pafajshëm. I vë me qëllim në peshojë këto dy qëndrime, sepse tash për tash nuk dihet kush ka të drejtë. Por, në media e rrjetet sociale, sidomos ndër ato që i kanë në shënjestër politikën e BDI-së, menjëherë iu turrën Bujarit (Osmanit): çka pret, jep dorëheqje!

Më duhet të them se ne që merremi me shkrime dimë të rrëmbehe-mi nga emocionet. Ndonjëherë fjalën e bëjmë mortë, pa u thelluar në disa gjëra që duhet t'i kemi parasysh. Jam i thart që kur të japim vlerësime, të nisemi nga parimi. Kështu në një këmbim mendimesh përmes rrjetit social, një miku ia vura në dukje pikërisht parimin. Cilin? Në rastin e përmendur ka disa që duhet pasur parasysh, por për fillim, ai që vlen në drejtësi: parimi i PRESUM-CIONIT TË PAFAJËSISË. Në drejtësi ai është i shenjtë dhe nënkupton që askush nuk është fajtor para se të dëshmohet fajësia e tij me vendim përfundimtar gjyqësor. Nuk është problem t'i thuash dikujt, hajt, tash, të kanë dyshuar, jep dorëheqje për shkaqe morale. Praktika në shoqëritë demokratike njeh këso situatash, nuk them se nuk mund të bëhet një veprim i tillë. Por, dhe nuk është

patjetër nëse dikush mendon se është i pafajshëm, në dallim nga media që dyshimin ose akuzën mund ta marrin si punë të kryer, para se për këtë të ketë gjyqi ta thotë fjalën e fundit.

Por, "presumpcioni i pafajësisë" nuk është i vetmi me të cilin ndeshemi. Parimi i radhës është ai i kutit, që e imponon praktika në një shoqëri të caktuar. A kemi kut të njëjtë? Bujari është ministër në qeverinë e kryeministrit Zaev, ndaj të cilit zhvillohej proces gjyqësor që para se ta merrte mandatin, dhe ai proces ka vazhduar edhe pasi u bë kryeministër! Sipas të njëjtës logjikë që kërkohet sot nga Bujari, pse nuk kërkohet dje nga Zaevi, çka e dallon njërin nga tjetri, në parim, kuptohet? Të mos kthehem në kohë edhe më mbura, e të kujtojmë se kryeministri është i falur nga kryetari Cërvenkovski nga vuajtja e dënimit me burg, për peshë shumë më të madhe se këto që i përmenden Bujarit. ... (Dhe duhet thënë qartë se pikërisht ky fakt e bën problematik edhe ndjekjen e gjithë garniturës së Gruevskit, sepse opozita shpesh e vë në dukje se një pushtet nga një i falur për vepra kriminale, ndjek të tjerët për vepra të njëjta. Ja dhe kjo ofertë e fundit e kryeministrit Zaev, vështirë se do të mund të kufizohet vetëm për veprat e 27 prillit dhe tentim vrasjet e deputetëve, por pikërisht gjatë lëndës që i proceson PSP-ja. Në këtë jam më se i sigurt. Sepse, nëse të gjithë iu vunë në qafë kryetari Gjorge Ivanov për faljen masive të tij, në një gjë ai kishte të drejtë: në të drejtën që ia jep kushtetuta për të falur dikë, njësoj siç atë të drejtë e kishte shfrytëzuar pararendësi i tij, pavarësisht se edhe në njërin edhe në tjetrin rast, rrënohej sundimi i së

drejtës njësoj për të gjithë, sepse çdokush duhet të përgjigjet për veprat e kryera, e jo të lirohet si i përkëdhelur nga kryetari zemërbutë ndaj bashkëpartiakëve të vet. Po të realizohej pajtimi i Zaevit, do të realizohej një barazimtar, por me kusht që ky kapitull të përfundonte me integrimin e Maqedonisë në EU dhe NATO dhe të mos përsëritej më si praktikë asnjëherë në të ardhmen. Por, kush do t'i kufizonte partitë që të mos e përsërisnin prapë praktikën e presidentit!

"LEGJITIMITETI" ZGJEDHOR: në Prokurorinë Speciale ishin dëgjuar disa incizime lidhur me një "strategji zgjedhore" të VMRO-së në zgjedhjet lokale të vitit 2013. Për një ide "gjeniale" se si në Strugë dhe Kërçovë të pengohen që të votojnë 400 shqiptarë mërgimtarë të ardhur apostafat. Kjo parti, e cila më shumë se dhjetë vjet lëvdohej se ka përkrahjen e popullit dhe thirrej në legjitimitet zgjedhor, i paska përsosur në maksimum metodat për arritje të rezultateve të favorshme: duke sjellë nga Prespa e Vogël shetas shqiptarë me letërnjoftime të dhëna enkas që të votojnë për VMRO-në atje ku do të kishte ndëvojë, ndërkaq mërgimtarëve shqiptarë shtetas të Maqedonisë, të pengohen me çdo kusht të arrijnë në vendvotime! Këtë strategji (me kërkesë drejtuar kontrollit të fluturimit për ta mbajtur aeroplanin sa më gjatë në qiell për gjoja pengesa në aeroport, për t'i vonuar shkallët që të zbresin udhëtarët, ose duke dashur që ta bllokojnë trafikun me prapsim traktori me rërë...Ja, me këtë lloj dredhish e ka fituar "legjitimitetin zgjedhor", anise si duket, as kjo s'ka pirë ujë në ato dy komuna.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovska lok.14 - përdhës, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e preme 19 tetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

VITI I MBRAPSHTË



Nga
Dr. Arben TARAVARI

Telenovela e emrit vazhdon. Nuk di pse kjo situatë më asocion me romanin "Viti i Mbrapshtë" të shkrimtarit Ismail Kadare.

Ngjarjet në roman zhvillohen në vitin e largët 1914, kohë në të cilën princ Vidi, i caktuar nga Ndërkombëtarët si mbret i Shqipërisë, e cila në atë botë ishte rrëmujë, nuk dihej ku fillonte dhe ku mbaronte. Në këtë mot të veçantë për shqiptarët, në qiell shfaqet dhe një kometë e cila interpretohet si ndjellakeqe për fatin e popullit dramatik me një histori edhe më dramatike.

Romani i Kadaresë është një nga të preferuarit e mi, sarkazma me të cilën shkrimtari i shpallur Princ i Asturias, përdor për të analizuar kombin e tij dhe kombin tonë, shqiptarët pra, është nga më të mprehtat dhe absolutisht e ndershme. Mirëpo sado përkon me sagën e atyre viteve, gjithsesi mbetet një roman, pra fikcion, pjellë e fantazisë së mendjes së begatë të Ismail Kadaresë.

Ajo që më shqetëson mua, është se sot jetojmë 1 shekull e 4 vjet më vonë se ngjarjet teatraliste të kombëtarëve e ndërkombëtarëve të vitit të kometës që desh bëri "qametin" dhe situata është në ku-

Habitem tek arrij të vështroj më ftohtë e qartë sjelljen e politikës përfaqësuese shqiptare, e cila është marrë në mirëbesim se përfaqëson shqiptarët, gjatë këtyre viteve kaotike, të cilat po arrijnë kulmin me largimin masiv të popullit që po ndodh ditën me diell e pa diell, natën me hënë a errësirë fare, se njerëzit po ikin kur të mundin e si të mundin!



fijitë e një romani interesant.

Ai që më ngushëllon është fakti që nuk jemi i vetmi popull i çuditshëm në Ballkan, falë Zotit kemi

sllavët që janë të çuditshëm e shpesh herë të çmendur madje, por mua më djeg më shumë populli im dhe kjo është një ndjenjë totalisht e përligjshme dhe e kuptueshme nga Amerika Kapitaliste e deri në Kinën Komuniste.

Habitem tek arrij të vështroj më ftohtë e qartë sjelljen e politikës përfaqësuese shqiptare, e cila është marrë në mirëbesim se përfaqëson shqiptarët, gjatë këtyre viteve kaotike, të cilat po arrijnë kulmin me largimin masiv të popullit që po ndodh ditën me diell e pa diell, natën me hënë a errësirë fare, se njerëzit po ikin kur të mundin e si të mundin!

Me probleme të mëdha, të pazgjidhura, të barazisë, të punësimin, të arsimit, të shëndetësisë e qindra probleme të tjera të shkaktuara nga ato të cituara më lart, politika përfaqësuese shqiptare çfarë ka bërë?!

Është pasuruar duke treguar se çfarë gabimesh ka tjetri. Janë zënë e janë grirë duke rrezikuar dhe vrasje liderësh e më pas janë puthur e përçafuar si dashnorë françez.

Kanë flirtuar me maqedonasit, me amerikanët, me shqiptarët e Shqipërisë e me ata të Kosovës, me Evropën merkeliste dhe me Evropën putiniste, me Gruevskin

dhe me Zaevin, me Rusinë dhe me Kinën e largët, ndonjëherë dhe pa e kuptuar aspak madje, pasi diplomacia nuk është pika e tyre e fortë. Me pak fjalë shqiptarët të bërë salla të nga politika dhe çuditërisht jo aq të kthjellët sa t'i kundërvihen, janë përfaqësuar deri tash nga një parti që ka thënë vetëm "Po" pavarësisht se cilin ka pasur përballë!

I vetmi rast ku duket se po i luan në këmbë është rasti i riemërtimit të Maqedonisë.

Shërrit për këtë proces ka qenë kaq i madh aq sa dhe vet Ndërkombëtarët po hutohen nga anomalitë që shfaq populli ballkanik dhe në 2018-ën.

Pas ndryshimit të emrit qëndrojnë aq shumë hesape të brendshme politike sa nuk ka kokë diplomati që i shokollavit.

Të vendosur në një pozitë të vështirë janë veçanërisht politikanët shqiptarë që na përfaqësojnë në pushtet. Ata kanë qënë dhe janë të lidhur fort me partinë nacionaliste dhe madje me krahun e saj me prirje shoviniste, si është ai gruevskist, por dhe me atë proevropian të Zaevit!

Për më tepër që disa nga funksionarët e partisë pozitiviste të BDI-së janë nën hetim për krime ekonomike të mëdha, situata

është tepër e vështirë për t'u menaxhuar!

Partia shqiptare që thotë gjithnjë "Po" ka hapur telashe me stilin e saj hipokrit...tash ndodhet në pozitën

"Bir Selman i nënës, kujt t'ia ndreq më parë, njërin e kam bir e tjetrin e kam djalë!"

Dilema të tilla nuk janë të lehta për t'u zgjidhur nga një parti që nuk di te zgjedhë tjetër përveç pushtetit...

Shërrit i emrit është nga më të rëndët që ka trokitur në derën e tyre...

Aq e komplikuar është për ta sa do i duhej ndonjë diplomat karriere si z. Henri Kisinxher për t'iu dhënë zgjidhje!

Unë nga pozita ime modeste ju sugjeroj që të zgjidhni Po-në më besnike që nuk ju tradhëton, atë evropiane, bindni dhe shokët tuaj të partive tjera, se ju jeni aq afër sa jam i sigurt që keni qëndrime të përbashkëta.

Bëni gajret burra, le të jemi njëherë normal në sy të Evropës dhe Amerikës, se nuk kanë aq kohë për t'u marrë me ne, sa do kishte fjala zëmë Serbia dhe Rusia...

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

Bisedimet Dardani-Serbi duhet t'i udhëheq Uashingtoni

Nga
Gani Mehmetaj

Shitetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO duhej t'u prinin nga fillimi bisedimeve të Dardanisë me Serbinë, nëse kishte nevojë për bisedime të kështilla. SHBA-të e BE-ja nuk është dashur të lejojnë cirkun e vajtje-ardhjeve maratonike në mes të Prishtinës e Beogradit në Bruksel, sepse Serbia ka dëshmuar edhe në të kaluarën, dëshmon edhe tash se nuk dëshiron të zgjidh asnjë problem në Gadishullin Ilirik. Ndërkaq, shtetarët e Dardanisë nuk janë treguar as të shkathët në bisedime, as që i përfill kush në propozime. Por edhe sikur ta kishim diplomacinë elitare, bisedimet me Serbinë do të dilnin shterpe.

Serbia është shaktari i krizës, ndërsa shaktari i krizës nuk mund të jetë çelësi i zgjidhjes. Është një gabim nismëtar diplomatik, që po na hakmerret, sepse çdo funksion elementar i shtetit

tonë është paralizuar nga kushtëzimet serbe. Serbia e humbi luftën me 1999, prandaj bashkësia ndërkombëtare s'duhej t'ia pranonte diktatet. Kushtëzimet nuk duhej t'ia pranonte as shteti ynë, edhe atëherë kur s'mund t'i kundërvihesh ushtarakisht, mjaftonte të tregonte vullnet kundërshtimi këmbëngulës.

Prishtina duhej të hiqte dorë nga bisedimet shterpe në Bruksel, kur shihej se delegacionet tona kot shkonin atje, pa asgjë kthehe-shin, sepse serbët i përsërisnin gjërat e njëjta si papagalli pa afruar asgjë.

Serbët e nxitën luftën në disa shtete të gadishullit, bënë gjenocid në Dardani, Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë, prandaj bashkësia ndërkombëtare gaboi kur i dha mundësi të kushtëzonte bisedimet me shantazhe. Kroatët u dhanë fund që në fillim shantazheve serbe me sëpatën e

dardharit e me diplomacinë e të mençurit. Ne nuk e patëm forcën ushtarake të kroatëve, nuk e patëm as mençurinë e diplomatëve. Ndërsa nuk ua kërkuam ndihmën, as nuk i përfillëm shpëtimtarët tonë SHBA-të, Britaninë e Madhe, Gjermaninë, Italinë etj.

Prandaj që të mos vazhdoj edhe më tutje cirku maratonik Beograd- Prishtinë, është mirë që bisedimet t'i udhëheq Uashingtoni, sepse pos që e kanë forcën ushtarake të zbatimit të marrëveshjes, ata e kanë edhe aftësinë që ta bindin Serbinë, ashtu si duhet t'i bindin. Serbët e kuptojnë gjuhën e amerikanëve më mirë se kushdo.

Nëpër kuluare thuhet kinsë "korrigjimet" i kërkon SHBA-ja, zyrtarët më të lartë amerikanë i mohojnë publikisht shpifjet e tilla. Pse të mos ua mbyllim gojën fjalëve të kuluareve?

Është gabim tjetër i pafalshëm që iu dha mandati kryeministrit

shqiptar Edi Ramës të zhvilloj bisedime me kryeministrin serb në Nish për fatin e Dardanisë. Ky shtetar i shantazhuar me dosje e i lëndueshëm politikisht e bëri rrëmujë shtetin e vet. Si mund të negocioj për neve atëherë?



Shteti ynë i ri gjendet para një kthesë dramatike, të ngjashme me vitin 1998-99. Atëbotë, ia kërkuam Amerikës e NATO-s ndërhyrjen urgjente, sepse nuk mund ta dëbonim agresorin serbë, nuk mundem ta shpëtonim kombin nga gjenocidi e rreziku i shfarosjes. SHBA e NATO na çlijuan e na shpëtuan. Do të na ndihmojnë e do të na nxjerrin nga situata kritike edhe tash, po i morën ata frenjë e bisedimeve. Përgjegjësinë do ta kenë shumë më të madh se sa tash si vrojtues pasiv.

Jam i sigurt që nuk do t'ua kërkojmë ndihmën, por ata duhet të ndërhyjnë pa na pyetur sa s'është bërë vonë.

kërkuam Amerikës e NATO-s ndërhyrjen urgjente, sepse nuk mund ta dëbonim agresorin serbë, nuk mundem ta shpëtonim kombin nga gjenocidi e rreziku i shfarosjes. SHBA e NATO na çlijuan e na shpëtuan. Do të na ndihmojnë e do të na nxjerrin nga situata kritike edhe tash



FJALËKRYQI KLASIK





HORIZONTALISHT: 3. Autori kroat, ujeviq; 5. Shkronjë greke; 7. Kryeqyteti i Çekisë; 9. Gadishull Grek; 10. Qytet në Turqi; 12. Vendbanim; 13. Prijësi i hunëve; 15. Enë që nxë një okë, okatare; 16. Pjesa e thelluar në sipërfaqe, varri; 18. Krijesë djallëzore në folklorin sllav; 20. Grupi i vogël dhe i mbyllur shoqëror me origjinë të përbashkët; 23. E moshës rinore; **24. Mbiemri i aktore shqiptare në foto;** 26. Lëndë djegëse që përdoret për ndriçim, për ngrohje etj.; 28. Aktorja amerikane, Besinxher; 29. Këngëtari nga Gostivari, Adhurim; 30. Bisk bime; 31. Shtet në Azinë Jugore, Shri; **33. Komedi me aktoren në foto;** 41. Futbollisti anglez, Stivën; 42. Këngëtari kosovar, Rexhepagiqi; 43. Krasit; 44. Pjesa rrotulluese e motorit; 47. këngëtarja Istrefi; 48. Përkrahja që i jepet dikujt pa të drejtë; 49. Vigan, kolos.

VERTIKALISHT: 1. **Emri i aktore në foto;** 2. Politikani kroat, Mesiq; 3. Trung druri për ndërtimin e çatisë; 4. Afër (krahin.); 5. Baballarë; 6. Këngëtari kroat, Rahimovski; 8. Një ndajfolje; 9. Përemër vetor; 11. Bimë e thjeshtë që rritet në vende me ujë; 12. Arsyeja, shkak; 14. Flori; 15. Një gur i çmuar; 17. Ushtruesit e okarinës; 18. Qytet në Rumani; 19. E drejta që i jepet dikujt për të bërë diçka; 21. Lundër e madhe, e gjatë; 22. Atdhetari ynë, Vokshi; 23. Inicialet e aktore Veizi; 25. Përemër pronor; 27. Lloj ibriku, bilike (sh.); 30. Kozmonauti rus, Juri; 32. Kërçova; 33. Aktori amerikan, Gregori; 34. Nevoja për të ngrënë; 35. Flas fjalë të ndyta; 36. Tirana; 37. Bashkëtingëllore të njëjta; 38. Aktori dibran, Dritëro; 39. Një stinë e vitit; 40. Pjata, sahani; 45. Aktori amerikan, Rajan; 46. Qytet në Korenë Jugore.

Kakuro

5x5 dhe 6x6

Kakuroja është kombinim i fjalëkryqit dhe Sudokut. Në vend të shkronjave shënohen numra edhe atë prej 1 deri 9. Numrat nuk duhet të përsëriten as horizontalisht e as vertikalisht. Numrat brenda fushave duhet t'i japin shumat, të cilat janë dhënë në skajet e fushave që duhet të plotësohen.




Koha, e shtunë, 20 tetor 2018



DOMINOJA

Plotësoni fjalëkryqin duke i bartur katrorët e dhëna më poshtë. Në fushat e hijëzuara do të fitoni emrin e përrallës në fotografi.



| | | |
|---|---|---|
| A | R | |
| | E | P |
| N | T | E |

| | | |
|---|---|---|
| A | R | I |
| G | I | L |
| F | T | A |



| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| R | T | U | I | S | T | I | | R | S | J | E | I | T | | M | E | R | N | I | |
| A | I | L | F | I | | S | I | L | U | A | R | P | E | T | A | R | I | G | | M |
| | S | O | | N | A | M | F | A | R | N | I | A | M | I | K | | M | A | L | O |
| I | O | Z | K | R | I | Ë | T | | M | A | G | | E | S | B | A | N | I | M | A |
| I | | E | O | S | T | | A | N | E | L | I | T | O | K | A | J | A | M | E | F |
| | E | N | | A | | I | R | Ë | R | A | R | E | N | A | J | Z | | A | T | A |

LABIRINTI

Ndihmoni miut të arrijë deri te djathi!



DALLIMET

Gjejini 5 dallimet!



Fshehësira

Ku fshehen 19 figurat e dhëna?



DEKODIMI

Lidhni pikat e zeza, duke filluar nga katrori i vogël dhe përfundoni te rrethi. Në fushat e pikave të zeza duhet të zgjidhni njëren nga katër shkronjat e dhëna dhe të vazhdoni në fushën tjetër. Në fund, lexuar me radhë do të fitoni gjidhjen e gjëgjëzës së autorit kosovar, Agim Metbala:

*"Nëna e vë në gisht,
Pëllumbi n'këmbë e mbanë;
E motra u gëzua shumë -
Kur për ditëlindje i dhanë!"*

| | | |
|--------|-------|--------|
| ABCC | DDhEË | FGGjH |
| IJKL | LIMNj | OPQR |
| RrSShT | ThUVX | XhYZZh |

Zgjidhja:

Mini SUDOKU

Në kutizat e dhëna duhet t'i shënoni numrat prej 1 deri 4. Tabelën do ta plotësoni duke i shënuar këto numra në fushat e zbrazëta, por me kusht që ato të mos përsëriten.

| | | | |
|---|---|---|---|
| 4 | 3 | | 1 |
| 2 | 1 | 4 | 3 |
| | | | |
| 1 | 2 | | |

SUDOKU "më i madh se"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejnë rregullat e sudokut. Shenja ">" paraqet relacionin "është më i madh se".

| | | | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|--|--|
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |

KENKEN

Përdoren numrat prej 1 deri 6. Vlejnë rregullat e sudokut. Numrat tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë numrit, operacionin matematikor.

| | | | | | |
|-----|-----|-----|----|----|-----|
| 2+ | | 2- | | 5- | |
| 2- | 11+ | | 2- | | 2+ |
| | 14+ | 20x | | 3÷ | |
| | | 3- | | | 3 |
| 11+ | 1- | | 6+ | | 12+ |
| | | 4- | | | |

ARUKONE (Çiftimi)

Bashkoni me vija numrat e njëjtë (çiftet). Vijat nuk guxojnë të priten. Duhet të përfshihen të gjitha fushat!

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 6 | | | 3 | 7 | 1 |
| | 4 | | 2 | | |
| | | 8 | | 1 | |
| | 2 | | | | |
| | | | | | 7 |
| 5 | | | | | |
| 6 | | | | | |
| | 5 | | 8 | | 4 |
| | | | | | 3 |

NONOGRAMI

Nxini fushat sipas numrave të dhëna. Numrat e dhëna e tregojnë numrin e fushave që duhet të nxihen.

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|--|--|--|
| | | | | | | | | | |
| | | 2 | 1 | | 1 | 2 | | | |
| | | 2 | 1 | 1 | 1 | 2 | | | |
| 1 | 1 | | | | | | | | |
| 2 | 2 | | | | | | | | |
| 1 | | | | | | | | | |
| 2 | 2 | | | | | | | | |
| 1 | 1 | | | | | | | | |



mini SKANDI me anagrame

Anagramet e dokumentarëve të regjisorit të tonë në foto i shënoni në fjalëkryq.

Dokumentari 1

NJË JETË PËR ATDHEUN

Dokumentari 2

MORA RRUGËN PËR MANASTIR

| | | | | | |
|---|---|--|---|---|--|
| PJESA E PARË E ANAGRAMIT TË DOKUMENTARIT 2 TË REGJISORIT NË FOTO) | M | PËRZIERJE BARNASH PËR SHERIM (BISED.) | LUMË NË KOSOVË | BAZAT E ARSIMIT TEKNIK | ANAGRAMI I DOKUMENTARIT 1, TË REGJISORIT NË FOTO |
| KAFSHË E THJESHTË NJËQELIZORE | | | | | |
| ATLETJA TURKE, AKTASH | | | | | |
| MJETE (BISED.) ERRËSOHEN | | | | | |
| E | | | | NU BAKËR | |
| PESHORE E VJETËR KANDAR | | REGJISORI I PARË SHQIPTAR I IMAGJONISË NË FOTO | PJESA E DYTË E ANAGRAMIT TË DOKUMENTARIT 2 TË REGJISORIT NË FOTO) | JO I KEQ DALIA E TOPIT JASHTË FUSHËS | |
| K | | | | KEC MASHKULL | |
| SHKURT, FROR (VJET.) QË LIDHET ME TEATRIN, TEATRORE | | | | NOMATOPE E PELLITJES SE LOPE'S LITRI | |
| T | | | | | AZOTI FEMRAT ME SHKOLLË |
| TEATRI NACIONAL | | | Ë. M. KËMBANË | | SH. Ë. NËPUNËS DIPLOMATIK |
| PJELLA E PELËS | | | | MARRËVESHJE NDERMJET SHITËTEVE TENISTI SPANJOLL, NADAL | |
| U JAP LEJË ZYRTARE | | | | | NGJYRA E KUJË E ENDEZUR IMITËSI |
| SHPREH ME FJALË NJË MENDIM | | | | | |
| TRI HERË ME TË MEDHA SE NJË TJETËR | | | | | |
| ARGJENDI | | | AMERIKANË NDAJ FOLJE SASIE | | |
| BANORET E NJË SHTETI EVROPAZATIK | | | | | ERBLUMI OKSIGJENI |
| BANOR PARARONJAK ITALISË | | | | | |
| | | | | | KOHA E LIRË |

Sudoku

i lehtë

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 3 | 4 | | | | | | |
| 5 | | | 8 | | | | | 6 |
| | 2 | | 5 | 1 | | | | 8 |
| | | 3 | | | | | | 2 |
| | 1 | 9 | 7 | | 2 | 6 | 5 | |
| 7 | | | | | 4 | | | |
| 9 | | | 8 | 3 | 2 | | | |
| 3 | | | 2 | | | | | 1 |
| | | | | 6 | 9 | | | |

mesatar

| | | | | | | | | |
|---|---|--|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 6 | | | | 3 | 7 | | |
| | | | 7 | 5 | | | | 9 |
| 2 | | | | | | | | |
| 6 | 2 | | 7 | 5 | | | | |
| | 9 | | 8 | | 4 | 2 | | |
| | | | 6 | 2 | | 9 | 4 | |
| 8 | | | | | | | | |
| 7 | | | 3 | 8 | | | | 1 |
| | 5 | | | | 8 | | | 6 |

i vështirë

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 5 | | | | | | |
| | | | | | | 8 | 1 | |
| | 7 | 6 | 4 | | | | | |
| | | | | 7 | 5 | | | |
| | | 9 | | | | | | |
| | 1 | | | | | | 8 | |
| 3 | | | | | | | 7 | 9 |
| | 9 | 4 | | | | | | 6 |
| 4 | | 2 | 5 | | | | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 6 | 7 | | | 1 | | |
| 9 | | | 5 | | | 2 | | 3 |
| | 4 | | | 2 | | | | |
| | | | | 1 | | | 4 | 6 |
| | | 3 | 2 | | 6 | 8 | | |
| 7 | 6 | | 3 | | | | | |
| | 8 | | 9 | | | | | 5 |
| 3 | | | | | 8 | 7 | | |
| | 2 | | | | 5 | | 8 | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 6 | 4 | 9 | 5 | | | |
| | | 7 | | 6 | 3 | 1 | | |
| | 9 | | | 1 | | | 6 | |
| | 5 | | | | | | | 7 |
| 7 | 4 | 9 | | | | 2 | 8 | 1 |
| 1 | | | | | | | | 5 |
| | 3 | | | 2 | | | | 1 |
| | | 2 | 9 | 8 | | 3 | | |
| | | 1 | 3 | 4 | 8 | | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | | | 3 | 4 | |
| | 9 | | | | | | 5 | 2 |
| | 4 | 3 | | | | | | 7 |
| | | | 4 | | 5 | | | |
| | 2 | 1 | | | | | | 3 |
| 4 | | | | 9 | | 7 | | |
| | 7 | | | 1 | | | | |
| | | 2 | 3 | | | | | 8 |
| 1 | | | | | 7 | | 6 | |

LUFTA CIVILE SHQIPTARE DHE PAVARËSIA E GREQISË

Disa historianë perëndimorë luftën e Greqisë për pavarësi e kanë cilësuar si luftë civile shqiptare. Shqiptarët myslimanë dhe katolikë kanë përbërë pjesën dërmuese të ushtrisë otomane që luftuan kundër pavarësisë së Greqisë në të cilën anë u gjetën shqiptarët ortodoks

Daut DAUTI/LONDËR

Më poshtë e keni përshkrimin e historianit të njohur George Finlay në lidhje me përleshjet e shqiptarëve katolikë e myslimanë me ata ortodoks me të cilin rast që vranë udhëheqësi i shqiptarëve suliot, Marko Boçari.

'Mustafë Pasha [Bushati] e mbledhi ushtrinë e tij në Ohër. Ushtria përbëhej nga 5000 myslimanë gegë dhe 3000 katolikë mirditas. Katolikët, të cilët flasin dialektin gegë të gjuhës shqipe, mburren me prejardhjen e tyre të krishterëve që kanë luftuar kundër turqëve nën udhëheqjen e heroit kombëtar Skenderbeut apo Gjergj Kastriotit. Por, urrejta e tyre për ortodoksët grekë që moti i ka lidhur më shumë në aleancë me fiset myslimane që janë afër tyre se sa me këdo tjetër të krishterë. Në këtë rast mirditasit formuan gardën sulmuese të ushtrisë së Mustafë Pashës. Ata mbahen për zotësi ushtarake të racës së tyre dhe e përqeshin kotësinë e grekëve të cilët kanë tentuar t'ua vjedhin lavdinë e Skenderbeut.

Grekët nuk u përgatitën që ta kundërshtonin Mustafën. Mavrokardatos e kishte braktisur Mezolongin. Derisa ishte aty, ai e kishte koncentruar veten tij në tri funksione: kryetar i Greqisë, Governori i Përgjithshëm i Krahinave Perëndimore dhe Komandant i Armatës së Etolisë. Por, kur u lar-

gua, i emëroi tre veta në këto pozita.

ZILIA GREKE E SAKRIFIKOI HEROIN SHQIPTAR

Përparimi i armatës së Mustafës bënte me dije për një përgatitje brilante ushtarake. Divizioni i parë i forcave otomane përbëhej nga 4000 ushtarë katolikë dhe myslimanë nën komandën e Xheladin Beut. Ata e vendosën kampin në luginën e Karpenisit, afër një shadërvani të braktisur me ujë të pastër që formon një përrua i cili rrjedh nga baseni saj që gjendet nën hije të një shelgu të vjetër dhe të bukur.

Në mesnatën e 21 gushtit 1823 toskët ortodoksë e befusuan kampin e gegëve myslimanë dhe katolikë. Marko Boçari, në krye të 350 suliotëve hyri në mes të armiqtëve të tij dhe nxitoi përpara për ta vranë beun. Trupat otomane u zgjuan nga gjumi dhe ikën si me reshje duke i lënë armët pas. Sikur kapitenët grekë të kishin sulmuar me armatolin e Etolisë dhe Akarnanisë, do ta asgjësonin ushtrinë turke. Por, zilia greke e sakrifikoi heroin shqiptar.

Beu i Ohrit e kishte vendosur tendën e tij në afërsi të një muri që ishte ndërtuar për t'i mbrojtur kosharet e bletëve apo qengjat nga jazbecët (lodhët) dhe dhelperat. Boçari iu afrua këtij muri dhe duke mos e gjetur hyrjen, e kishte ngritur kokën për të shikuar mbi te në mënyrë që të gjente mundësinë të

hynte me përcjellësit e tij.

Tashti, alarmi i kishte ngritur nga gjumi veteranët e Xheladinit të cilët kishin përvojë me befasi të natës. Disa prej tyre kishin qenë në roje kur Boçari e kishte ngritur kokën mbi mur dhe kur ai ishte parë në qiellin gri. Një plumb menjëherë ia shpoi kokën dhe suliotët e kapën trupin e tij. Madje, edhe pas kësaj, disa granata dore do t'i zbrapsnin rojet e Xheladinit nga hapësira e mbyllur dhe do ta perfundonin disfatën e forcave turke. Por, suliotët nuk kishin mësuar asgjë nga arti i luftës gjatë përvojës që kishin patur me rusët, francezët dhe anglezët në ujëdhësat e Jonit. Sikur shumë egërsira tjera luftarake, edhe suliotët e urrenin dobishmërinë e shkencës. Dhe, pasoja e kësaj ishte se veprimi i tyre fitues, tashti ishte stopuar nga një mur i ndërtuar si mbrojtje kundër dhelperave dhe jazbecëve. Por, para se të tërhiqeshin me trupin e udhëheqësit të tyre, suliotët i mbledhën dhe i bartën gjërat që i kishin plaçkitur. Otomanët nuk u orvatën aspak që t'i pengonin gjatë tërheqjes për në Mikroherio ku arritën të shoqëruar nga një varg i mushkave që i kishin zënë në kamp e që i kishin mbushur me plaçkë.

MADHËSHITIA E PAGUAR SHTRENJTË

Plaça e luftës ishte shumë e vlefshme por vdekja e Marko Boçarit ua mbushi shpirtin me errësirë.



Ushtarët grekë në fshatrat fqinje të Tranakhoriot dhe Nostimos, kur u bë vonë, u turëpruan nga mosaktivizimi i tyre dhe i fyen kapitenët e tyre për shkaktimin e vdekjes së udhëheqësit më trim që kishte armata greke.

Ndodhia në Karpenis është një nga shembujt e palës së dytë e cila e rivalizon racën dominuese otomane. Grekët e kanë bartur këtë [cilësi] gjatë luftës dhe revolucionit grek. Otomanët, të cilët e shoqëruan armatën e Mustafës, mbetën ende në fushën e Thesalisë. Grekët ishin pozicionuar të paangazhuar në kodra. Beteja u zhvillua në mes gegëve katolikë dhe toskëve ortodoksë.

Ushtria e Xheladinit mbeti në posedim të fushëbetejës dhe i varrosën të vdekurit menjëherë. Dy udhëtarë anglezë që kaluan atypari gjatë verës që erdhi, kishin parë një numër të kryqave të vogël të vendosur mbi varret e mirditasve.

Suliotët, të cilët luajtën rol në këtë ndodhi të shadërvanit dhe shelgut, e që nuk harrohet, për një kohë të gjatë, u dalluan me ornamentet e tyre të pasura dhe të ngarkuar me armë të çuditshme. Por, shumica e tyre u penduan për madhështinë e paguar shtrenjtë dhe mendonin se i kishin marrë këto të mira gjatë një nate të mallkuar dhe thoshin se do të ishte më mirë për ta dhe për grekët sikur Marko [Boçari] të ishte ende gjallë dhe sikur ata të kishin vazhduar të bartnin pushkët e thjesh-ta të etërve të tyre. Sukses i suliotëve nuk e pengoi përparimin e ushtrisë së Mustafës. Gegët e tij vazhduan me etje që të hakmerreshin për humbjet dhe ta fshinin njollën në reputacionin e tyre ushtarak. Grekët i braktisën pozitat e tyre në Tranakhorio dhe tentuan pa sukses që ta mbronin luginën në mes të dy maleve të rrëmbyeshme, Kelidonit dhe Kalliakudit.'



Lufta mes Kosovës dhe Serbisë ka shënjuar jetën e shumë njerëz-

ve. Si pasojë e kësaj lufte u dëbuan mijëra njerëz dhe shumë të tjerë u

KËNGËTARI RRËFEN HISTORINË E DHIMBSHME

“LUTESHA TË VDISJA I PARI”

ekzekutuan. Një prej personave që e ka vuajtur këtë periudhë, është dhe këngëtari i njohur Mentor Haziri. I ftuar tek “Rudina” ai tregoi për momentet e vështira të luftës që kaloi ai dhe familja e tij.

Haziri tha se ushtarët serbë kishin rrethuar 500 persona në një mal për t'i ekzekutuar dhe se në ato momente, ai lutej të vdiste i pari që të mos shihte atë që mund të ndodhte me të dashurit e tij.

“Në kohën e luftës kur flluan bombardimet, ne ikëm në një

fshat në Kosovë dhe 2 javë më vonë filluan të na sulmojnë forcat serbe. Në orën 08:00 të mëngjesit kemi dalë 500 veta në mal dhe aty na kanë kapur të gjithëve, na kanë mbajtur disa orë dhe na kanë plaçkitur. Më pas, na vunë në rend për të na vranë, ndanë burrat veç dhe gratë veç dhe prisnin urdhër për të na vranë. Është histori shumë e dhimbshme. Në ato momente ajo çfarë mendon një njeri është që të vdesë i pari, që të mos shohë se çfarë do të ndodhë. Lutesha të

vdisja i pari. Por 500 veta nuk mundën të na vrasin, sepse do të ishte masakër e madhe, nuk morën urdhër për të na vranë. Na nxorën në autostradë dhe aty unë jam ndarë nga familja ime. Mua më kanë ngritur në tren dhe kam qëndruar për një muaj në Maqedoni dhe kam punuar për refugjatë të tjerë. Deri kur është çli-ruar Kosova nuk kam patur asnjë kontakt me familjen time dhe nuk kam ditur asgjë për ta”, tregoi këngëtari i njohur.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe të mediave nga Lugina e Preshevës e kanë ftuar presidentin Thaçi që të marrë pjesë në një tryezë diskutimi dhe në promovim të një libri për Luginën e Preshevës, që për qëllim kanë promovimin e paqes dhe stabilitetit në rajon

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të premtënka pritur përfaqësues të shoqërisë civile dhe të mediave nga Lugina e Preshevës. Presidenti Thaçi i ka falënderuar ata për punën që janë duke bërë në promovimin e të drejtave të shqiptarëve, në rrethana shumë të vështira.

“Qytetarët e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit janë komuniteti më i diskriminuar në Evropë dhe kjo gjendje duhet të përmbyllet njëherë e përgjithmonë”, u shpreh presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit ka thënë se në këtë takim kanë biseduar edhe për kërkesën e liderëve politikë dhe të shqiptarëve atje për respektimin e referendumit të vitit 1992 për bashkëngjitjen e Luginës së Preshevës

PËRFAQËUESIT E LUGINËS E FTOJNË THAÇIN T’I VIZITOJË



me Republikën e Kosovës.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe të mediave nga Lugina e Preshevës e kanë ftuar presidentin Thaçi që të marrë pjesë në një tryezë diskutimi dhe në promovim të një libri për Luginën e Preshevës, që për qëllim kanë promovimin e paqes dhe stabilitetit në rajon.

“Ju falënderoj edhe për ftesën për të marrë pjesë në promovimin e librit dhe në tryezën për promovimin e paqes në rajon. Do t’i shqyrtoj të gjitha mundësitë për të

marrë pjesë atje, për kohën që ju keni planifikuar”, ka thënë presidenti Thaçi. Ndërsa, aktivisti Sevdail Hyseni nga OJQ Perspektiva, ka thënë se presidentit Thaçi ia kanë përcjellë shqetësimet e shoqërisë civile dhe të popullatës së atjeshme për vështirësitë që ballafaqohen. “I treguam se jeta kulturore në Luginë është në një stad shumë të rëndë, ndoshta është kthyer si në kohën e regjimit diktatorial. Pa zhvillim të arsimit, gjuhës dhe kulturës, nuk mund të kemi përparim

shoqëror dhe kombëtar”, ka thënë Hyseni. Ai ka shtuar se në këtë takim kanë biseduar edhe për idenë e korrigjimit të kufirit, proces që do të mundësonte bashkëngjitjen e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit me Kosovën.

“Ideja për korrigjimin e kufirit është e qëlluar dhe në kohën e duhur. Ne përmes pak mjeteve të informimit po mundohemi ta afirmojmë këtë ide. Kufiri i tillë duhet të korrigjohet që mos të kemi telashe në të ardhmen”.



Putin: Kosova s’ka mbajtur referendum për shpalljen e pavarësisë

Presidenti rus Vladimir Putin ka deklaruar se Krimea nuk është ruse sepse rusët kanë ardhur dhe kanë rrëmbyer diçka, por sipas tij banorët e saj përmes referendumit kanë kërkuar t’i bashkohen Rusisë, transmeton Zeri.info.

“Krimea është e jona... Pse e jona? Jo pse kemi ardhur dhe kemi grabitur diçka”- ka thënë Putin gjatë një debati.

“Këtu mbretëron demokracia. Çka është demokracia? Është pushteti i popullit. Si vendoset ajo? Përmes referendumit, zgjedhje, etj. Njerëzit kanë dalë në referendum në Krime dhe kanë votuar: Duam të jemi, të pavarur dhe hapi tjetër të jemi pjesë e federatës ruse”- ka sqaruar Putin.

Presidenti rus po ashtu e ka krahasuar këtë situatë me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, kur vendimi është marrë pa mbajtur referendum, në bazë të votimit në parlament, ku më pas janë pajtuar të gjithë ata që e kanë mbështetur shpërbërjen e ish Jugosllavisë.

“Ejani të diskutojmë, të shikojmë dokumentet e OKB-s, të shohim cila është konventa e Kombeve të Bashkuara, ku shkruhet për të drejtën e popujve për vetëvendosje. Do të diskutojmë pafund. Por ne nisemi nga vullneti i njerëzve që jetojnë në këtë territor”, ka përfunduar Putin.

Vuçiq: Ushtria e Kosovës na mbështet për muri



Kryetari i Serbisë Aleksandar Vučić është takuar sot me zëvendësndihmësin e Sekretarit amerikan të Shtetit Matthew Palmer.

Me këtë rast, ata më së shumti kanë biseduar për Kosovën, rreth të cilës kanë mospajtime, pasi, ka thënë Vuçiqi, SHBA-ja e njeh pavarësinë e saj tash e 10 vjet, ndërsa Serbia jo, transmeton Koha.net.

“Jemi të kënaqur që amerikanët po i dëgjojnë mendimet tona për Kosovën edhe pse ata nuk pajtohen me ne rreth kësaj çështje”, citon blic i Beogradit të ketë thënë Vuçiqi.

Një pjesë e madhe e bisedës i është kushtuar Ushtrisë së Kosovës.

“I kam thënë se formimi i Ushtrisë së Kosovës, nëse ndodh, do të na mbështesë për muri prej nga nuk do të kishim shtegdalje”, ka thënë Vuçiqi dhe ka shtuar se amerikanët kur flasin për këtë Kosova ka të drejtë në formimin Ushtrisë pasi është shtet i pavarur dhe sovran. Për takimin me Vuçiqin ka folur edhe zyrtari i lartë amerikan: “Kosova ka të drejtë në transformimin e FSK-së në Ushtri, por kjo do kohë”, ka thënë Palmer.

Arben Imami: Rama dhe Basha po ndajnë paratë

Arben Imami ka thyer hehshjen, e gati pas një mungese 1-vjeçare në arenën politike, ish-ministri ka qenë i ftuar në studion e “Top Talk” ku ka folur për situatën politike në vend. Çështja më e përfolur e momentit është rasti “Babale” e akuzat e opozitës për qeveri të kriminalizuar. E për Arben Imamin opozita e sotme ka shumë të drejtë në denoncimet e saj për një qeveri të kriminalizuar, e për këtë s’mund të kritikohet në vetvete.

Sipas Imamit, “e gjithë PD është vënë në dispozicion të Bashës për të marrë sa më tepër

para nga Edi Rama”.

Ai shprehet se nuk ka guxuar të flasë më parë sepse nuk ka pasur fakte, por tanimë ka një pasqyrë të qartë.

“Punët shkojnë mirë. Paratë bëhen. E ka thënë Topalli në një konferencë më parë. Unë nuk kam guxuar të flas sepse nuk kisha ende fakte. Por tani kemi një pasqyrë të plotë që paratë po bëhen nga të dyja palët njësoj. Po ndahen paratë. Është shumë e qartë, që edhe për marrëveshjen iu dha edhe një shumë jo e vogël në dorë. E gjithë PD po punon për të rritur pozicionin negociues të



Lulzim Bashës për të marrë sa më shumë para nga Edi Rama”, u shpreh ai.

“Basha nuk lejon më as forcimin e opozitës”, theksoi Imami,

teksa vlerëson se vendi duhet të shkojë në zgjedhje që opozita të forcohet: “Ajo çfarë them është se nëse nuk shkojnë njerëzit tek kurtia e votimit për të zgjedhur qeve-

rinë e tyre, sistemi demokratik nuk funksionon më”.

I pyetur nëse a ka një aleancë mes Bashës e Ramës, imami u përgjigj: “Nuk mund intereson se çfarë ka ndodhur pas skene, por ajo çfarë ka ndodhur në skenë. Zgjedhjet që u humbën vitin e kaluar, nuk u humbën vetëm prej drogës dhe parave, por edhe për 250 mijë zgjedhës që humbën besimin tek opozita”

Sipas tij me Lulzim Bashën kryetar do të jetë e pamundur që opozita të kthejë mbrapsht zgjedhës të humbur.

Disa imazhe satelitore të shpërndara ekskluzivisht nga CNN tregojnë se Rusia po investon për të përmirësuar katër prej instalimeve të saj ushtarake në Kaliningrad, qytetin strategjik të saj në pikën ku ndodh ndarja kufitare me NATO-n.

NATO E SHQETËSUAR

CNN ZBULON FUQIZIMIN E ARSENALIT RUS NË BALTIK



Kaliningradi – territor rus që gjendet mes Polonisë dhe Baltikut, por i shkëputur nga pjesa tjetër e Rusisë, është i njohur si një enklavë që gjithmonë ka qenë pikë fokale në tensionet ndërmjet Rusisë dhe Perëndimit.

Më parë këtë vit, u zbuluan imazhe ajrore që tregonin se rusët kishin modernizuar ndjeshëm një bunker të magazinimit të armëve bërthamore në Kaliningrad. Tani, imazhet satelitore dhe analiza nga ImageSat International, një firmë tregtare satelitore, duket se konfirmojnë se një modernizim i madh është duke u zhvilluar në të paktën katër baza ushtarake në të gjithë rajonin.

Këto përmirësime përfshijnë punën e freskët në atë që analistët e kanë identifikuar si vendi i magazinimit të armëve bërthamore të Kaliningradit. Imazhet e kapura midis 19 korrikut dhe 1 tetorit tregojnë punën që po kryhet në një bunker të ekspozuar në rinovim që duket se fsheh aktivitet ushta-

rak nën vete.

Imazhet e tjera tregojnë 40 bunkerë të rinj në ndërtim e sipër, çka do të thotë rritje e kapacitetit në një zonë magazinimi ushtarak pranë Primorsk, portit të dytë më të madh të Rusisë në Detin Baltik. Bunkerët e rinj rrethojnë bunkerë më të mëdhenj dhe më të vegjël në qendër të bazës.

Imazhet e 18 korrikut tregojnë bunkerët në ndërtim e sipër, ndërkohë 10 javë më vonë, bunkerët duken të plotë.

Në një distancë të shkurtër në

veri të Kaliningradit, imazhet tregojnë gjithashtu përmirësime në bazën ajrore Chkalovsk, duke përfshirë një hekurudhë të re dhe instalimin e një sistemi të uljes së instrumentit që do të lejonte avionët të mbërrinin në një kohë të keqe.

Një grup përfundimtar i imazheve tregon përmirësimet në Chernyakhovsk, një bazë që strehon Brigadën e 152-të të raketave të ushtrisë ruse. Në shkurt, baza mori raketa me aftësi bërthamore "Iskander", duke bërë që një zyrtar i mbrojtjes amerikane ta

quante atë "masa më e madhe që kemi parë" në aspektin e militarizimit rus të Baltikëve.

Ushtria ruse nuk iu përgjigj menjëherë kërkesës së CNN për të komentuar dëshmi të reja të modernizimit ushtarak në Kaliningrad, por qeveria ruse ka mbrojtur vazhdimisht të drejtën e saj për të vendosur armë atje.

Kaliningrad ka rëndësi për shkak të vendndodhjes strategjike, por Perëndimi është shprehur njëzëri se "nuk do të frikësohemi". "Është shumë e rëndësishme

për ta [rusët] sepse ky është porti i tyre në detin Baltik", tha Admirali James G. Foggo III, komandanti i Forcave Detare të SHBA-së në Evropë-Afrikë dhe komandant i Komandës së Forcave të Përba-shkëta Aleate në Napoli, Itali.

"Ata nuk kanë një urë tokësore që shtrihet në atë zonë... dhe kështu ata e kanë ndërtuar atë me kalimin e kohës".

Foggo, i cili nuk komentoi drejtpërsëdrejti imazhet e reja, tha se prania e Rusisë në enklavë nuk e pengon NATO-n që të veprojë në rajon. "Nëse ata duan të na sfidojnë, ne do t'i sfidojmë ata", tha ai. "Ne nuk do të frikësohemi nga ato sisteme që janë atje".

Por zyrtarët ushtarakë amerikanë thonë se ata janë të shqetësuar nga ajo që ata e quajnë aftësinë e Rusisë për të krijuar aftësitë "anti-çesës / area denial", ose armatimin që zvogëlon lirinë e mundshme të NATO-s për të manovruar në rajon. Ato përfshijnë disa nga sistemet moderne të armëve të stacionuara në Kaliningrad, duke përfshirë raketat anti-anije, sistemet e radarëve dhe raketat sipërfaqësore-ajrore.

ISH-SHEFI I INTELIGJENCËS BRITANIKE ME DETAJE TË REJA Princi Salman urdhëroi vrasjen e Khashoggit dhe se kishte lejen e ShBA-ve

Ish shefi i MI6 ka thënë që të gjitha provat tregojnë se Princi Mohammed bin Salman i Arabisë Saudite ishte pas vdekjes së gazetarit Jamal Khashoggi, dhe që teoria se elementë të jashtëm në ushtrinë saudite e kanë bërë një gjë të tillë është "trill blatant", shkruan The Guardian, përkthen në shqip Periskopi.

Sir John Sawers i tha BBC-së se këto mendime ishin bazuar në bisedimet e tij me burime të rëndësishme në Whitehall dhe në dijenitë që kishte marrë nga shërbimet e inteligjencës në Turqi.

Komentet u bënë pasi që presidenti amerikan Donald Trump kishte thënë që prezumonte se Khashoggi kishte vdekur dhe që pasojat për Arabinë Saudite do të ishin shumë të rënda nëse liderët e këtij vendi do të evidentoheshin të ishin fajtor për vrasjen.

Sawers, që ishte kreu i shërbimit sekret britanik deri më 2014, poashtu pretendon se princi mund të ketë vepruar vetëm nëse e kishte lejen nga Shtëpia e Bardhë për të vepruar si të donte.

Policia turke kërkon në pyll trupin e gazetarit saudit

Policia në Turqi, që po heton vrasjen e dyshuar të gazetarit saudit, Jamal Khashoggi, i zgjeroi hetimet.

Zyrtarët turq thanë se trupi i tij mund të jetë hedhur në pyllin pranë konsullatës saudite në Stamboll. Khashoggi, kritik i udhëheqjes saudite, u pa për herë të fundit duke hyrë në këtë konsullatë, më 2 tetor. Turqia dyshon se ai u vra, Arabia Saudite thotë se nuk di për fatin e tij. Mostrat e marra nga konsullata saudite dhe rezidenca e konsullit, gjatë bastisjeve këtë javë, po testohen, për të parë nëse përkojnë me ADN-në e Khashoggit. Turqia ka thënë se ka prova me zë dhe video se Khashoggi është vrarë, por ato nuk janë bërë publike.

Incidenti ka shkaktuar tensione të konsiderueshme midis Riadit dhe aleatëve perëndimorë.

Sekretari amerikan i Thesarit, Steven Mnuchin, dhe sekretari britanik i Tregtisë, Liam Fox, janë zyrtarët e fundit të lartë që u tërhoqën nga pjesëmarrja në një konferencë të madhe investimesh, që do të mbahet javën e ardhshme në Riad. Ndërkohë, Sekretari amerikan i Thesarit Steven Mnuchin dhe Sekretari i Tregtisë i Mbretërisë së Bashkuar Liam Fox janë



tërhequr nga një konferencë investimi në Arabinë Saudite. Vendimi vjen mes akuzave se Arabia Saudite mund të qëndrojë pas vrasjes së gazetarit saudit Jamal Khashoggi. Khashoggi nuk është parë që kur hyri në konsullatën saudite në Stamboll më 2 tetor, ku zyrtarët turq pohojnë se ai u vra. Arabia Saudite, e cila mohon vrasjen, lejoi hetuesit të kontrollonin Konsullatën. Ministrat e financave holandeze dhe franceze, si dhe disa politikanë të tjerë dhe udhëheqës të biznesit, kanë thënë gjithashtu se nuk do të marrin pjesë në aktivitet. Z. Mnuchin njoftoi se do të tërhiqet nga samiti, pas një diskutimi me Presidentin Donald Trump dhe Sekretarin e Shtetit Mike Pompeo.

Kur kanë kaluar 16 ditë nga zhdukja e gazetarit saudit, Jamal Khashoggi, edhe Presidenti amerikan Donald Trump beson se ai ka vdekur. "Gazetari i zhdukur saudit Jamal Khashoggi duket se ka vdekur, tha presidenti Trump për gazetaret, duke thënë se do të ketë pasojat "të rënda" për këdo që qëndron pas këtij krimi. "Pasojat e mundshme për Arabinë Saudite do të duhet të jenë shumë të rënda," tha Trump të enjten, përpara nisjes për në Montana. Kjo është një gjë e keqe, por do të shohim se çfarë do të ndodhë. Nëse nuk ndodh ndonjë mrekulli e të gjitha mrekullive, do të pranoj se ai është i vdekur", tha Trump për gazetaret e "New York Times" brenda Zyrës Ovale



NP TREGU I QYTETIT Ohër

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159 dhe 164-b i Ligjit për mbrojtje shëndetësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 43/12145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16)...

SHPALLJE PUBLIKE Për punësim për kohë të pacaktuar

- 1. IPSHU Klinika për gjinekologji dhe obstetrikë – Shkup ka nevojë për punësimin e : 2 (dy) mjek të medicinës për specializim të anatomisë patologjike (histopatolog) 1 (një) mjek të medicinës specialist i anatomisë patologjike (histopatolog)...

IPSHU KLINIKA PËR GJINEKOLOGJI DHE OBSTETRIKË – SHKUP

Në bazë të nenit 110-e të Ligjit për mbrojtje sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 77/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15, 30/16, 163/17, 51/18) dhe nenin 20-g dhe neni 20-g dhe 21 pika 1 dhe 2 të Ligjit për të punësuarin në sektorin publik...

SHPALLJE PUBLIKE për punësim të 2(dy) realizuesve për kohë të pacaktuar të punës në IP për akomodim të personave kërkuës të së drejtës për azil

IP për akomodim të personave kërkuës të së drejtës për azilil " Qendra e pranimit të kërkuësve të azilil" - Shkup, publikon shpallje publike për punësim të 2(dy) realizuesve për kohë të pacaktuar të punës për pozitat në vijim:

- 1. SO30303A05004 Psikolog nëpunës profesional nga nivel i pestë 1 (një) realizues 2. SO30303A06002 Jurist i diplomuar nëpunës profesional nga nivel i gjashtë 1 (një) realizues
- Kandidatët duhet të plotësojnë si në vijim kushtet e përgjithshme të vërtetuara në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP për akomodim të personave kërkuës...

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e republikës së Maqedonisë të cilët i plotësojnë kushtet për konkurrim. Kandidatët me fletëparaqitjen duhet të dorëzojnë dëshmitë për plotësimin e kushteve, në formë origjinale apo kopje të verifikuara në noter...

NP TREGU I QYTETIT Ohër

Në bazë të nenit 22 pika 1 dhe neni 23 të Ligjit për marrëdhënie pune dhe neni 5 nga Marrëveshja kolektive të Ndërmarrjes publike për menaxhim me tregje me shumicë dhe pakicë Tregu i Qytetit Ohër, Drejtori i NP Tregu i Qytetit Ohër, shpall si në vijim:

SHPALLJE PUBLIKE nr. 04-447/1 për plotësimin e vendit të punës për kohë të pacaktuar të personelit ndihmës teknik

NP Tregu i Qytetit Ohër ka nevojë për: Bravapunues - saldus - 1 (një) realizues

- 1. Numri rendor, shifra dhe titulli i vendit të punë: 29. KDR 0401 A01 098 –Bravapunues saldus -1 (një) realizues

Kushtet e përgjithshme - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë; - Të njëh në mënyrë aktive gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik; - Të jetë i moshës së rritur; - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës

Kushtet e veçanta: -Kualifikime profesionale: -niveli i kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET apo MKSOO apo arsim të mesëm katërvjeçar, Përvojë pune: dy vite;

Orari i kohës së punës: e hënë-e premtë Orari i punës: 07:00 deri 15:00 ora Neto pagesa e vlerës së pagës: 13.687.00 denarë, plus shtesë për mundin e kaluar për 0.5% për çdo vit stazh të punës

Për plotësimin e kritereve të lartpërmendura të përgjithshme dhe veçanta, kandidatët janë të obliguar të dorëzojnë edhe dëshmi përkatëse në original apo kopje të verifikuara në noter edhe atë: -Fletëparaqitje të plotësuar e publikuar në ueb faqen e NP Tregu i Qytetit Ohër -Biografi të shkurtë e obligueshme të shënuar kontakt telefon dhe adresë -Certifikatë shtetësie -Certifikatë nga libri amë i të lindurve -Vërtetim për përvojë pune e cila kërkohet për vendin e punës -Certifikatë mjekësore për aftësinë e përgjithshme shëndetësore (jo më të vjetër se 6 muaj)

Shpallja zgjat 5 (pesë) ditë pune, duke llogaritur nga dita e publikimit në tre gazeta ditore, nga e cila në një gazetë e cila botohet në gjuhë të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedone.

Procedura për selektim për punësim të personelit ndihmës teknik në ndërmarrjen përbëhet prej kontrollit të të dhënave të shkruara në fletëparaqitjen për punësim me kushtet e vërtetuara në shpalljen publike, kontroll të dëshmitëve të parashtruara me fletëparaqitje dhe intervistë.

Vërejtje: Në pajtim me Planin vjetor për punësim për vitin 2018 punësimi është paraparë maqedonas.

kandidatët e interesuar fletëparaqitjet me dokumentacionin e nevojshëm të dorëzojnë deri te arkiva e NDËRMARRJES PUBLIKE PËR MENAXHIM ME TREGJE ME SHUMICË DHE PAKICË TREGU I QYTETIT Ohër, Bul. "Turisticka" nr.79 Ohër, apo me postë me shenjë "PËR SHPALLJE" në afat prej 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes. Fletëparaqitjet jo në kohë dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Republika e Maqedonisë Република Македонија

Projekt për përmirësimin e shërbimeve komunale – MSIP Проект за подобрување на општинските услуги - МСИП

MSIP-NCB-076-18

1. Kjo thirrje për ofertë e përcjellë shpalljen e përgjithshme për furnizim të këtij projektit e shpallur në gazetën e UN Development Business, me nr. 767, 31 Janar, 2010 (botim i shtypur) dhe e shpallur në mënyrë elektronike më 06 Janar 2010.

2. Republika e Maqedonisë mori kredi nga Banka Ndërkombëtare për Obnova dhe Zhvillim (IBRD), për realizim të Projektit për përmirësimin e shërbimeve komunale (MSIP) dhe ka për qëllim që mjetet e fituara nga ky kredi të përdoren për pagim të kontratës për "Rekonstruim të kulmit të SHF "Rajko Zhinzifov" Komuna e Çairit"

3. Komuna e Çairit i thirr ofertuesit më të kualifikuar dhe më të pranueshme të japin oferta të shtypura për punë ndërtimore të cilët përfshijnë rekonstruim të kulmit dhe vendosja e instaluesve të rrufesë

4. Procesi i ofertimit do të realizohet përmes procedurave për oferta nacionale publike ashtu si është e specifikuar në Udhëzimin e Bankës Botërore: Furnizim me mjete të fituara nga IBRD hua dhe IDA kredite, nga janari 2011 dhe është i hapur për të gjithë ofertuesit nga vendet më të pranueshme ashtu si është e definuar në dokumentacionin e tenderit.

5. Ofertuesit e interesuar të pranueshëm mund të marrin informacione plotësuese në adresën e përmendur më poshtë prej ora 08:30 deri 16:30: Adresa: Bul. Hristijan T. Karposh 5Град: Скопје Numri i postës: 1000 Shteti: Republika e Maqedonisë Telefon: 02 2603 007 Faks: +389 2616867 Adresa elektronike: info@cair.gov.mk

6. Dokumentacionin e tenderit në gjuhën maqedonase mund ta blejnë të gjithë ofertuesit e interesuar me parashtrimin e aplikimit me shkrim në adresën e dhënë më poshtë dhe pas pagimit të taksës jokthyese prej 1.000,00 denarë. Metoda e pagesës do të jetë përmes formularëve PP50, në llogarinë në vijim:

a) Për pagesë në denarë: Banka: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë Numri i llogarisë: 100000000063095 Llogaria buxhetore shfrytëzuese: 783014119063019 Konto e të ardhurave: 724125, mënyra 00 Qëllimi: për dokumentacionin e tenderit

7. Dokumentacioni i tenderit do të dorëzohet përmes postë elektronike ose mund të merret drejtpërdrejt në Komunën e Çairit.

8. Ofertat patjetër të dorëzohen në adresën e dhënë më poshtë deri në orën 12:00 më 20.11.2018 Dorëzimi në mënyrë elektronike të ofertave nuk lejohet. Ofertat e vonuara do të refuzohen. Ofertat do të hapen fizikisht në praninë të përfaqësuesve ofertues të cilët do të zgjedhin praninë personale në adresën e dhënë më poshtë më 20.11.2018 ora 12:00.

9. Të gjitha ofertat duhet të jenë të bashkangjitura me Garanci bankare prej 90,000,00 denarë. 10. Adresa:Komuna e Çairit, Bul. Hristijan T. Karposh 5 Qyteti: Shkup Numri i postës: 1000 Arkivi Shteti: Republika e Maqedonisë

LIGA E PARË - JAVA E X

SHKËNDIJA MYSAFIRE E VARDARIT, SHKUPI PRET SILEKSI

“Natyrisht presim të jetë ndeshje e vështirë në një terren që nuk është se jep kushtet më ideale për lojë, por ne jemi të bindur të japim më të mirën në kërkim të rezultatit pozitiv në këtë përballje”, u shpreh sulmuesi i Shkëndijës së Tetovës, Besart Ibrahim

Koha

Fisnik NUHIU

Shkup, 19 tetor - Pas pauzës që kishim në kampionatin vendor në Ligën e Parë futbollistike, të dielën do të rikthen ndeshjet e javës dhjetë. Derbi i javës do zhvillohet mes kampionit aktual Shkëndija dhe liderit të tabelës Vardarit. Kjo përballje do të zhvillohet në stadiumin “Boris Trajkovski” në Maxhari. Ekipi i Shkëndijës e ka shfrytëzuar pauzën që të përgatitet sa më mirë për përballjen me Vardarit dhe presin që të kthehen në rrugën e fitoreve. “Na pret ndeshje derbi por që ka rëndësi si çdo takim tjetër dhe nuk i japim vetes ndonjë presion shtesë. Kemi punuar mirë në pauzën kampionale, besoj se secili prej neve futbollistëve kemi mundur të marrim veten dhe të gatsëm presim takimin e radhës. Natyrisht presim të jetë ndeshje e vështirë në një terren që nuk është se jep kushtet më ideale për lojë, por ne jemi të bindur të japim më të mirën në kërkim të rezultatit pozitiv në këtë përballje”, u shpreh për gazetën Koha, sulmuesi i Shkëndijës së Tetovës, Besart Ibrahim. Në takimin mes Vardarit dhe Shkëndijës do të mungojnë tifozët mysafirë “Ballistët”, pas kjo përballje është shpallur e rrezikut të lartë. “Duke pasur parasysh rrezikun e lartë të këtij takimi, edhe kjo ndeshje do të nënshtrohet ndalimit për prezencën e tifozëve mysafir. Të njëjtëve nuk do ju lejohet hyrja në tribunat e stadiumit. Gjatë blerjes së çdo bilete, do të kërkohet mjet identifikimi. Bileta do të kushtojë 100 denarë. Ndalohet futja e çdo mjete piroteknik, mjeteve të rënda, ashtu që apelojmë deri tek të gjithë



TAKIMET E JAVËS SË 10

VARDARI - SHKËNDIJA
SHKUPI - SILEKSI
RENOVA - RABOTNIČKI
BELLASICA - POBEDA
MAKEDONIJA GJ.P - AKADEMIJA P.

simpatizantët për një anim fer dhe korrekt në tribuna. Të tregojmë sjellje sportive dhe të dëshmojmë se Vardari ngadalë, por me meritë po rikthehet aty ku edhe e ka vendin, në krye të tabelës”, thuhet në njoftimin e skuadrës së Vardarit. Nga ana tjetër, skuadra e FC Shkupit është duke kaluar një periudhë të vështirë në kampionatin vendor, ndërsa edhe të dielën në stadiumin e Çairit e pret një ndeshje e vështirë përballë Sileksit të Kratovës, mirëpo Shkupi në këtë përballje do të futet për të marrë fitoren e parë nën drejtimin e trajnerit të ri Umit Karan dhe për të dalë nga kriza e rezultateve që e ka kapluar ekipin nga Çairit në kampionat. “Vërtet jemi në një periudhë të vështirë dhe në krizë rezultatet, por mendoj se kjo pauzë ishte e mirëseardhur për të punuar së bashku me ekipin dhe trajnerin e ri, që të përgatitemi në planin fizik dhe të punojmë edhe në pjesën taktike. Definitivisht nuk meritojmë të jemi në pozitën e fundit, por jam i sigurt se për kohë të shkurtë kjo do të ndryshojë. Kemi

ekip të mrekullueshme në të cilën unë besoj, kemi kualitet për të siguruar dalje në Evropë dhe mendoj se është koha për ta dëshmuar këtë. Të dielën na pret një ndeshje e vështirë, pasi që përballjet me Sileksin gjithmonë kanë qenë të vështira, ata janë një ekip e fortë, por ne nuk na mbete asgjë tjetër përveç se të firojmë dhe të dalim nga kjo krizë. Falënderim të madh deri tek tifozët, të cilët edhe përkundër rezultateve të dobëta që i kemi treguar, po na përkrahin në secilën ndeshje. Shpresoj që të dielën më në fund do të fitojmë dhe do ti gëzojmë”, theksoi Igor Aleksovski. Për ndeshjen ndaj Sileksit, trajneri Umit Karan i ka të gjithë futbollistët në dispozicion, përveç Basilio Ndong, i cili është lënduar në paraqitjen me reprezentacionit të tij. Në takimet tjera skuadra e Renovës do të jetë nikoqire e Rabotniçkit. “Gjipspunuesit”, gjatë 4 ndeshjeve të fundit kanë arritur të marrin 10 pikë, jo që ka bërë të renditen në vendin e katërt në tabelë. Të dielën Renova do të kërkon fitoren e radhës ndërsa kësaj herë me trajnerin e ri Nikolla Ilievski “Xhixhi”. Në ndeshjet tjera Bellasica do të pret Pobodën dhe Makedonija GJ.P para tifozëve vendas luan me Akademija Pandevin. Të gjitha takimet zhvillohen ditën e diel me fillim prej ora 14:30.



Në Kërçovë themelohet klubi i ri i volejbollit për femra KV “Uskana”

Shkup, 19 tetor - Qyteti i Kërçovës nga ky vit i është shtuar një klub i volejbollit për femra KV “Uskana”, që do të garon në Ligën e Parë të Maqedonisë. Për Kërçovën ky klub do të jetë historikë pasi është klubi i parë shqiptar i volejbollit, klub që femra kërçovare do të ketë mundësinë të shprehë talentin e saj dhe të përfaqësojë qytetin e saj në vend e më gjerë. Profetori i Edukatës Fizike dhe trajneri i njohur i volejbollit, Bejtulla Emini me kënaqësi ka njoftuar themelimin e klubit Uskana. “Me këtë akt të themelimit dhe garimit të këtij klubi në Superligën e Maqedonisë në volejball, shfrytëzojmë rastin të falënderojmë të parin e komunës sonë, Fatmir Deharin, i cili e mbështeti me kënaqësi idenë tonë dhe premtoi përkrahje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive. Gjithashtu një falënderim të posaçëm meriton Matt Ahmedi, kërçovari që jeton në SHBA, i cili u kujdes për të kompletuar të gjithë ekipin me uniformë sportive, po ashtu edhe afaristë të tjerë të Kërçovës që kanë shprehur gatishmëri për të ndihmuar klubin financiarisht. Po ashtu njoftojmë të gjithë prindërit, të cilët janë të interesuar që vajzat e tyre t’i regjistrojnë për t’u stërvitur dhe luajtur volejball, ngase KH “Uskana”, ka edhe shkollën e volejbollit për mosha të reja”, deklaroi trajneri i klubit Bejtulla Emini. Ndryshe klubi i sapoformuar KV “Uskana” që nga dita e shtunë do të fillon garat në kampionat ndërsa takimin e parë do ta zhvillojë ndaj ekipit të KV “Pelisteri Volej” nga Manastiri. “Do të jetë një derbi i rëndësishëm për ne sepse në këtë takim presim të dëshmojmë lojë cilësore edhe pse jemi fillestarë në këtë drejtim. Shpresoj të marrim një rezultat pozitiv, rezultat që do të motivonte edhe më shumë volejbollistët tona që në takimet e radhës të korrin edhe më shumë suksese”, tha trajneri Emini. (F.H.)

KK FATI ORGANIZON TURNEU I 17 NDËRKOMBËTARE TË KARATESË

Shkup, 19 tetor - Gjatë ditës së shtunën (20 tetor) në qytetin e Tetovës nën organizimin e klubit të karatesë “Fati” do të mbahet turneu i 17 me radhë ndërkombëtare i karatesë “Tetova Open 2018”. Në këtë turne do të marron pjesë klube nga vendi si dhe nga vendet si Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, BeH, Bullgaria, dhe Serbia, si dhe do të ketë mbi 450 garues. “Në këtë turne kemi ftuar klube nga Maqedonia, Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Bullgaria, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia. Të gjitha



këto shtete kanë konfirmuar ardhjen dhe presim masivitet të madh në Tetova Open. Turneu “Tetova Open” është një ndër turnet më të organizuara dhe më masovik në vendin tonë pasi ar-

rijmë të mbledhim mbi 450 garues”, deklaroi trajneri i KK Fati, Arlind Huseini. Turneu do të zhvillohet në sallën e sportit të shkollës mesme e mjekësisë në Tetovë, me fillim në orën 10:00, ndërsa hapja solemne është caktuar në ora 12:00. Garat do të zhvillohen në kata dhe kumite në të gjitha kategoritë për djem dhe vajza. Organizatori për të gjithë më të mirët do të ndajë kupa, medalje dhe diploma, ndërsa shpërblime do të ketë edhe për ekipet më të mira. (F.N.)

"Kjo duket shumë e padrejtë. Nuk kritikohet vetëm Leo, por shpesh të gjithë lojtarët argjentinas. Nuk është e lehtë për të luajtur në kombëtaren e një vendi, që ka emergjencë për ta fituar titullin. Argjentina ka një histori që peshon, mbart brenda saj epokën e Maradonës. Diego peshon shumë si figurë, sepse ishte shumë popullor në Argjentinë", ka theksuar Xavi

XAVI KUNDËR MARADONËS: MESSI ËSHTË LIDER ABSOLUT, NJË "BISHË" KONKURRUESE



Xavi thyen heshtjen nga Katarri, ku po kalon hapat e fundit të një karriere të gjatë e mbresëlënëse. Mesfushori legjendar i Barcelonës ka folur për disa çështje me programin radiofonik "Super Sport Villa Trinidad", duke përfshirë situatën e Lionel Messit me Argjentinën, kritikën e Diego Armando Maradonës ndaj tij, Botërorin e Rusisë, Lopetegui etj. Lidhur me kritikën ndaj Messit dhe sportistëve argjentinas, Xavi nënvizoi: "Kjo duket shumë e padrejtë. Nuk kritikohet vetëm Leo, por shpesh të gjithë lojtarët argjentinas. Nuk është e lehtë për të luajtur në kombëtaren e një vendi, që ka emergjencë për ta fituar titullin. Argjentina ka një histori që peshon, mbart brenda saj epokën e

Maradonës. Diego peshon shumë si figurë, sepse ishte shumë popullor në Argjentinë. Para se të flasim për aspektin e besimit, i cili është shumë i rëndësishëm, tani lojtarët argjentinas nuk shkojnë me gëzim në kombëtare. Kjo është një situatë shumë e vështirë. Prandaj nuk po bën mirë Argjentina, parvarësisht nga fakti nëse luan Messi apo ndonjë lojtar tjetër. Ata duhet të jenë të fortë mendërisht,

duke u përpjekur për ta gjetur suksesin. Le të bëjnë si ne në vitin 2008, në Kampionatin Europian me Spanjën, dhe të përpiqen ta shkundin pluhurin e viteve, sepse historia e futbollit argjentinas peshon shumë". Duke iu referuar të ardhmes së "10" tek Argjentina, mesfushori i shquar spanjoll shtoi: "Sigurisht që ne do të vazhdojmë të habitemi nga Messi, sepse gjithmonë kemi gjëra të reja

prej tij, sepse dominon në të gjitha aspektet e lojës, është në gjendje ta bëjë një gol i vetëm, të kalojë në mes të linjave, të driblojë tre, ose katër kundërshtarë. Ai është një lojtar stratosferik dhe këtë e shohim nga loja në lojë. Leo ka shërbyer 14 vite në një klub. Ai është ende 31 vjeç, por derisa të mbushë 34, apo 35 vjeç, do të ndihet shumë mirë. Akoma ka për të luajtur në futbollin e elitës, kësh-tu që do të kemi shansin për ta parë, duke dhuruar spektakël në fushat e lojës. A do të kthehet në kombëtare? Unë mendoj se po. Pse të mos kthehet. Ai ka nevojë për disa kohë reflektim, për të pushuar. Në fund është vendimi i tij dhe i trajnerit për të vazhduar. Ai është lojtari më i mirë në botë. Messi e ka fjalën e fundit, por unë mendoj se, herët a vonë, do të kthehet tek Argjentina, sepse është një person shumë konkurrues, një "bishë" konkurruese. Ai do të përpiqet të fitojë me Argjentinën, prandaj do të kthehet. Kritika e Maradonës ndaj Messit? Për mua, Leo është një udhëheqës i pabesueshëm, si ja-

shtë dhe brenda fushës. Ndoshta qëndron i qetë në dhomat e zhveshjes, edhe i heshtur disi, por është një lider absolut. Gjithmonë dëshiron topin, e ofron atë për shokët rregullisht, ka personalitet, kurrë nuk është fshehur. Unë e kam pasur atë në ekipin e parë të Barcelonës, ka qenë gjithmonë në ballë, i ka dhënë frymëzim grupit. Personalisht, mendoj se kemi të bëjmë me një lojtar, që ka kapacitet prej lidhësi-pi absolut, "shtazarak" në këtë kuptim. Pra, nuk jam dakord me Maradonën. Unë e urrej faktin se disa ish-futbollistë janë kaq kritikë. Nuk po ndalem në rastin e Maradonës, por flas në përgjithësi. Ish-futbollistët komentues nuk mund të jenë shumë kritikë ndaj kolegëve të tyre, sepse ata kanë qenë atje, i dinë vështirësitë". Xavi Hernandes flet edhe për ndjesinë e të qenit kampion bote: "Të jesh kampion i botës është si të jesh në Disney, është një ndjenjë e mrekullueshme. Njerëzit ende të kujtojnë ty dhe do të të mbajnë mend gjithë jetën. Kur fiton Botërorin, ke bërë histori", ka theksuar Xavi Hernandes.

Publicitet

Në bazë të nenit 114, 176, dhe 217 paragrafi 2 të Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 82/2018), Dekani i Fakultetit pedagogjik "Shën Kliment Ohridski" në Shkup, publikon

KONKURS për zgjedhje të një mësimitdhënësi në të gjitha titujt mësimit shkencor

1. Behët shpallja e konkursit për zgjedhje të një mësimitdhënësi në të gjitha titujt mësimit shkencor

1.1 Metodikë (5504) dhe Pedagogji (50500), për lëndët

- Strategjia dhe teknika e punës në shërbimin profesional (lëndë obliguese për grupin studimor Bibliotekist) dhe

- Praktika pedagogjike (lëndë obliguese për grupin studimor Mësimi klasik në gjuhën mësimore maqedonase)

1.2 Pedagogjia (50500) për lëndët:

- Kultura e medimeve (lëndë zgjedhore për grupin studimor Edukata parashkolllore dhe Mësimi klasik në gjuhën mësimore maqedonase dhe grupin studimor bibliotekist) dhe

- Marrëdhënie të bibliotekës me publikun (lëndë zgjedhore, për grupin studimor Bibliotekist)

2. Kandidatët të cilët do të paraqiten në konkurs duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme nga Ligji për arsim të lartë

(Gaz. zyrtare e RM nr. 82/18) si dhe kushtet në pajtim me kriteret ekzistuese të dhëna në Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje të titujt mësimit-shkencor, shkencor, mësimit-profesional dhe bashkëpunues dhe asistent-doktorant të Universitet "Shën Kliment Ohridski" në Shkup (Lajmëtar i universitar nr. 274/2013 - tekst i pastruar).

Kandidatët të cilët do të paraqiten në Konkurs duhet të dorëzojnë:

- fletëparaqitje

- biografi të shkurtër, me fotokopje të vendimit për zgjedhje në titujt, nëse kanë zgjedhje të mëparshme në titujt

- diplomë për shkallën e arritur përkatëse të arsimit - doktor i shkencave nga sfera shkencës për të cilën zgjidhen,

- formular të plotësuar me raportin për zgjedhje në titujt mësimit-shkencor, shkencor, mësimit-profesional dhe titujt bashkëpunues, mund të merret në arkivin e fakultetit

- deklaratë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës listë të punimeve recensuese shkencore të publikuara në botime shkencore referente, në 5 vitet e fundit para se të botohet shpallja për zgjedhje dhe

- certifikatë të shtetësisë

Fletëparaqitjet e kandidatëve dorëzohen me rekomandim përmes postës apo në arkivin e Fakultetit, në afat prej 8 ditë duke

llogaritur nga dita e publikimit të Konkursit në shtypin ditor.

Kandidati i zgjedhur do të themelojë marrëdhënie pune për kohën për të cilën është zgjedhur

Dekan
Prof. dr. Emil Sulejmani

SHPLLJE PUBLIKE

Gjykata Themelore Kriva Pallankë ka nevojë për nënshkrimin e marrëveshjes për punësim në kohë të caktuar për vendet e punës në vijim:

1. "Referent gjyqësor - daktilograf", me kohë të caktuar prej 2 (dy) muaj, me orar të plotë të punës, duke llogaritur prej 01.11.2018 deri më 31.12.2018 - 1 (një) realizues dhe

2. "Referent i ri gjyqësor - korrier", me kohë të caktuar prej 2 (dy) muaj, me orar të plotë të punës, duke llogaritur prej 01.11.2018 deri më 31.12.2018 - 1 (një) realizues.

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë kushtet e parapara me nenin 21 të Ligjit për shërbim gjyqësor (të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë, të përdorin gjuhën maqedonase në mënyrë aktive, të jenë të moshës së rritur, të kenë aftësi të përgjithshme shëndetësore, dhe me akt të plotfuqishëm të mos kenë ndalesë të kryerjes së profesionit, veprimtarisë apo detyrës), dhe kushtet e parapara me aktin e sistematizimit të vendeve të punës (të kenë të përfunduar së paku arsim të lartë apo të mesëm, të njohin në mënyrë aktive programet kompjuterike për punë në zyrë dhe për vendin e punës nga pika 1 (referent gjyqësor - daktilograf) të kenë së paku 1 (një) vit përvojë pune në profesion (për vendin e punës "referent më i ri gjyqësor - korrier" zgjidhet kandidati me apo pa përvojë pune).

Orari javor i punës zgjat prej të hënën deri të premtën, orari ditor i punës fillon më 07:30 dhe përfundon më 15:30, ndërsa pauza gjatë orarit të punës zgjat prej 11:00 deri më 11:30.

Vlera në të holla e pagës themelore mujore neto për vendin e punës nga pika 1 është 16.446.00 den, ndërsa për vendin e punës nga pika 2 është 15.235.00 den.

Afati për paraqitjen e kandidatëve zgjat 3 (tre) ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor, ndërsa përzgjedhja e kandidatëve do të kryhet në afat prej 3 (tre) ditë pas skadimit të afatit të paraqitjes.

Paraqitjet, së bashku me dokumentet me të cilat dëshmohet plotësimi i kushteve të parapara në konkurs të dorëzohen direkt apo me dërgesë të rekomanduar deri te Gjykata Themelore Kriva Pallankë-Kriva Pallankë, rr" Shën. Joakim Osogovski", nr. 142, tel. 031/375-322, personi për kontakt Mllagjan Mitovski, udhëheqës i repartit gjyqësor.

Paraqitjet e pakompletuara dhe jo në kohë nuk do të merren parasysh gjatë realizimit të përzgjedhjes. Kandidatët e paraqitur në afat prej 5 (pesë) ditë pune nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes për punësim me shkrim do të njofohen për personat që janë zgjedhur dhe do të kthehen të gjitha dokumentet që i kanë parashtruar si dëshmi për plotësimin e kushteve të kërkuara për kryerjen e punës.

GJYKATA THEMELORE KRIVA PALLANKË

Korrigjim i shpalljes publike për punësim

Në shpalljen e publikuar për pranimin e punonjësve shëndetësorë dhe bashkëpunjësve shëndetësorë në kohë të pacaktuar pune IPSH Spitali Klinikë Tetovë nr.04-4343/2 me datë 10.10.2018, publikuar në shtypin ditor "KOHA" me datë 12.10.2018 (e premtë)

Korrigjim:

Për vendin e punës me nr. rendor 3. Radiolog Teknolog - ALP Kandidatët e paraqitur do të nënshtrohen dhënies së provimit - pjesa profesionale (Testim).

IPSH Spitali Klinikë Tetovë



Tel: 02 3179 - 904, Fax: 3118 - 060
marketing@koha.com.mk

Janë humbur dëftesat dhe diploma e SHM Cvetan Dimov - Shkup të personit Bedri Qail dhe njëkohësisht shpallen të pavlefshme.

Drejtuesit e Bayernit kanë akuzuar median se po e sulmojnë pa asnjë logjikë klubin legjendar gjerman dhe kanë paralajmëruar se tani e tutje nuk do të pranojnë më shpifje dhe sulme pa bazë, duke kërcënuar edhe me gjyq

SHEFAT E BAYERNIT KËRCËNOJNË: SULMET NUK I TOLEROJMË MË!



Bayerni lajmëroi ditën e djeshme një konferencë të jashtëzakonshme për shtyp, ku do të merrnin pjesë drejtuesit më të lartë të klubit, presidenti Uli Hoeness, shefi ekzekutiv Karl-Heinz Rummenigge dhe drejtori sportiv Hasan Salihamidzic. Të tre së bashku kishin dalë për herë të fundit kur prezantuan Jupp Heynckes, pas largimit të Carlo Ancelottit nga stoli bavarez, por këtë radhë dalja publike ka qenë vetëm një sulm i ashpër ndaj mediave. Në kor, drejtuesit e Bayernit kanë akuzuar median se po e sulmojnë pa asnjë logjikë klubin legjendar gjerman dhe kanë paralajmëruar se tani e tutje nuk do të pranojnë më shpifje dhe sulme pa bazë, duke kërcënuar edhe me gjyq. "U mbloodhëm të hënën, pas ndeshjes kundër Holandës, dhe vendosëm që nuk do e pranim më këtë stil pune, këtë sulm konstant ndaj lojtarëve të veçantë. Kemi lexuar gjithçka, por asgjë në lidhje me paraqitjet, vetëm sulme

ndaj lojtarëve. Dinjteti i lojtarëve nuk mund të preket, me ligj, ndaj ne te Bayern nuk do ta lejojmë të ndodhë më. Nuk kam fjalë të përkrahur ndjesinë kur kam lexuar disa gjëra për Manuel Neuer. Si mund të kritikohet Neuer, apo të shkruhen gjëra të tilla për Hummels e Boateng? E njëjta gjë vlen edhe për Ribery e Robben. Këta djem kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në dekadën e fundit për ta bërë Bayern-in një yll të shndritshëm në futbollin botëror. Kur lexoj këto debate për moshën

e tyre, më duken polemika boshe. Dua t'iu kujtoj gazetarëve gjermane se ata dhe kolegët e tyre kanë thënë se transferimi më i madh i këtij sezoni është një 33-vjeçar (Cristiano Ronaldo). "Kemi 6 vite që festojmë, kemi fituar gjithçka të mundshme dhe Gjermania ka fituar Botërorin në 2014. Me shumë lojtarë nga Bayerni. Edhe ne kemi mbetur të pakënaqur nga rezultatet dhe stili i lojës, por nuk ia lejojmë vetes të sillemi keq me lojtarët. Do t'i mbrojmë, edhe ligjërisht, lojtarët tanë. Neuer nuk ka pa-

sur fat në ndonjë ndeshje, si në Augsburg, apo ndaj Holandës, por kjo nuk është arsye për ta hedhur në plehra. Nuk duam ta gjejmë shkakun e krizës te mediat, nuk duam lëvdën nëse humbasim, por duam mbulim serioz dhe me fakte. Ne kemi kanalet tona, do t'i bëjmë gjërat si duam ne tani e tutje", ka deklaruar Rummenigge. "Është e rëndësishme që klubi më i rëndësishëm në Gjermani të respektohet nga mediat. Është e pabesueshme dhe mungesë totale respekti ajo që ndodhi me trajne-

rin e kombëtares Jogi Löw, ai nuk e meriton këtë sjellje. Shembull tjetër? Salihamidzic dhe Kovac shkuan në një ndeshje basketbolli dhe 4-5 persona po fishkëllenin. Çfarë bën Bild? Shkon dhe i kërkon Telekomit nëse mund të marrë pamjet filmike. Kjo është mungesë respekti. Nuk kthehet gjithçka përmbys për 14 ditë". Hoeness për Bernat: "Na sulmojnë dhe kritikojnë pse shitëm Bernat, sikur humbja ndaj Gladbach erdhi se mungonte ai. Por ai lojtar thajse na kushtoi Champions League në Seville kohë më parë dhe më pas vendosëm ta shisnim. Bavaria ka qenë gjithnjë një familje dhe nuk i sulmojmë lojtarët tanë, edhe nëse Neuer gabon, qoftë edhe 4-5 ndeshje. Secili ka opinionin e vet, bilanci bëhet në fund të sezonit dhe do të shohim kush ka pasur të drejtë". Hoeness për kritikën e ashpër ndaj Mesut Ozil: "Po, nuk duhej të thosha që ka luajtur si plehrë, duhej të përdorja fjalën papastërti. E pranoj që pas ndeshjeve thuhën gjëra nga emocionet e forta, gabova edhe me kritikën ndaj Bellarabi, nuk duhej të thosha 'i sëmurë mendor'", theksoi Hoeness.

Mund të qëndroj përgjithmonë te Chelsea

Eden Hazard vazhdon me raundin e tij të intervistave, edhe pse në të fundit, të cilën e dha për "Sky Sports", ai prezantoi një mundësi, që deri më tani nuk kishte qenë argumenti kryesor i përgjigjeve të tij. Nëse belgu ka folur gjithmonë se dëshiron të luajë në Spanjë dhe më konkretisht te Real Madridi, tani flet për të qëndruar përgjithmonë te Chelsea.

"Unë mund të përfundoj duke qëndruar këtu te Chelsea, nuk do të ishte problem. Jam i lumtur këtu, në këtë klub dhe këtë ekip. Familja ime është e lumtur këtu. Nëse nuk shkoj në Spanjë, nuk është fare problem. I dua tifozët dhe mendoj se edhe ata më duan. Çfarëdo që të ndodhë në të ardhmen, do të jem i lumtur", tha Hazard për "Sky Sports".



Modric dhe 40 milionë euro, Real përgatit ofertën e çmendur për Inter

Luka Modric ishte ëndrra e zikaltërve në merkaton e verës dhe drejtori sportiv i mialenzëve, Piero Ausilio, bëri gjithçka ishte e mundur për ta marrë kroat. Megjithatë, kjo sagë mund të mos ketë mbaruar akoma, të paktën sipas lajmeve që vijnë nga Spanja. Sipas "Diario Gol", në fakt, Real Madrid duan Mauro Icardi-n dhe janë të gatshëm të përfshijnë Modric në këtë operacion të mundshëm. Mediat spanjolle kanë shkruar se "Los Blancos" do të ofrojnë 40 milionë euro, plus kartonin e Modric për të bindur zikaltrit që të heqin dorë nga kapiteni i tyre verën e ardhshme. Mbetet për t'u parë se cila do të jetë përgjigja e Inter para kësaj oferte. Verën e kaluar, Icardi kishte një klauzolë 110 milionë euro të përfshirë në kontratën e tij, e cila nuk ekziston më, dhe ka shumë mundësi që Inter të kërkojë një shifër më të lartë për argjentinasin.

Benzema largohet nga Reali vetëm për Situn ose PSG

Karim Benzema mund të largohet nga Real Madridi, por vetëm në dy destinacione. Ylli francez u transferua në vitin 2009 nga Lyoni te Mbretërit dhe që nga ajo kohë ka qenë një titullar fiks në formacionin e Real Madridit. Benzema ka qenë pjesë e rregullt e formacionit të çdo trajneri në Bernabeu dhe ka qenë gjithashtu njëri nga të preferuarit e presidentit Florentino Perez. Me kalimin e kohës, Benzema ka filluar të kontestohet nga tifozët shkaku i formës së tij, por drejtuesit asnjëherë nuk



kanë menduar largimin e tij. Në verën e këtij viti, sulmuesi francez pati ofertë nga klubi italian Milani, por që në fund nuk u ma-

terializua një transferim i tij. Sipas mediumit Mediapart, Benzema do të linte Real Madridin vetëm për një transferim te Manchester City ose Paris Saint-Germain. Faqja e internetit pretendon të ketë një regjistrim të një mesazhi të dërguar nga sulmuesi tek një nga punonjësit e tij, në të cilin ai deklaroi se për këtë e ka refuzuar një lëvizje te Milani. Çmimi i lojtarit mendohet të jetë rreth 50 milionë euro dhe në rast largimi, Reali do të hidhet pas Mauro Icardit dhe Harry Kane.



DASHI 21. mars - 20. prill

Mos u përfshini shumë nga ankthi, pasi në të kundërt rrezikohet që tensionet t'iu shpërqundrojnë. Parashikohet një e premte mjaft e favorshme për të bërë paqe në familje ose në dashuri.



DEMI 21. prill - 21. maj

Do të argëtoheni nga sjellja e partnerit/es tuaj, pasi më në fund do të ndiheni të vlerësuar. Megjithatë shmangni përfshirjen në diskutime të cilat nuk ju përkasin drejtpërdrejt, sidomos në vendin e punës.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Parashikohen mundësi shumë të mira për të rënë në sy dhe për të treguar se sa vleni në vendin e punës. Duhet të jeni gati për të përveshur mëngët, pasi përkushtimi në punë, do ju lejojë që të keni sukses. Në dashuri para se të merrni një vendim, bëni mirë të reflektoni.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Kjo fundjavë do të jetë interesante për të pushuar më shumë dhe për t'u marrë më shumë me veten. Mos nënvlerësoni ndonjë problem shëndetësor, për shkak se mund të përkeqësohet.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Kjo e premte do ju gjejë shumë dembelë dhe gjithçka pasi nuk do arrini që të përqendroheni siç dëshironi. Ka disa mendime dhe shqetësime që nuk ju lejojnë të shfrytëzoni më mirë kohën e kaluar me familjen ose me partnerin/en. Marrëveshjet e punës janë mjaft të favorshme.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Parashikohet një ditë mjaft intensive, për gjithë ata që kanë dëshirë të ndërmarrin rrugëtime të reja profesionale. Këshillohet që të jeni më të komunikueshëm dhe fleksibël në raport me bashkëpunëtorët tuaj.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Do të jeni të lodhur dhe kjo gjë mund të ndikojë në çështjet e punës. Jeni në prag të mbylljes së disa negociatave vendimtare për karrierën tuaj, kështu që jini të përqendruar. Vlerësoni maksimalisht kohën e kaluar me familjen dhe miqtë.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Kjo e premte ju fton që të reflektoni më shumë lidhur me problematikat të ndryshme, e sidomos për familjen. Ka disa problematika të cilat duhen zgjidhur sa më parë. Duhet të dëgjoni më shumë mendimet e të tjerëve dhe të mos këmbëngulni me kokëfortësi. Sfera e ndjenjave do të jetë mjaft e qetë.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Do të përfshiheni në një projekt interesant dhe inovativ i cili do të stimulojë krijimtarinë tuaj. Do të ndiheni më të fortë dhe të sigurtë në vete dhe për këtë arsye do të arrini të përpunojnë strategji suksesi. Këshillohet që të mos e lini pas dore partnerin/en tuaj.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Më në fund do arrini një objektivi që i keni vendosur vetes prej kohësh, por çmimi që do paguani do jetë shumë i lartë. Do të jeni agresiv dhe aspak tolerant, ndaj shmangni diskutimet e kota ose në të kundërt rrezikoni që të keni reagime të tepruara.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Mos jeni shumë negativ dhe konfliktual në vendin e punës. Natyrisht puna në grup nuk është e lehtë, sidomos nëse jeni të detyruar të përballeni me persona kokëfortë, po aq sa ju. Kjo e premte duhet t'iu gjejë më diplomatë dhe mundohuni të ruani ekuilibrin. Mbrëmja favorizon takimet.




PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Këshillohet që gjatë kësaj dite të pushoni më shumë, të relaksoheni dhe të lini mënjatë gjithë ato çështje që ju kanë vendosur nën presion. Kjo e premte është mjaft interesante për të nisur planifikimet lidhur me aktivitetet e reja në çift. Ndryshimet, udhëtimet ose transferimet janë mjaft të favorshme.

| | | | | | | |
|---|---|--|---|--|----------------------------------|---|
| Koha Koha | KËNGËTARJA E NJOHUR AMERIKANE NGA FOTO | PËRUIROVA | ELEMENT KIMIK (NI) | D. Ç. | NJËSIA MONETARE E JAPONISË | FLORI |
| E KUNDËRTA E PERËNDIMIT | ○ | | | | | |
| ▶ | ○ | | | | | |
| USHTAR KEMBËSOR I TRUPAVE OSMANE LLOJ GJEDHI AZIATIK | ○ | | | NORVEGJIA MBRETI I KAFSHEVE | | |
| DYLUFTIMI | ○ | | | | | |
| SHTËPI ESKIMEZE (PREJ AKULLI) | ○ | | | | ARMIQËSI | |
| GLASGOW UNIVERSITY | ○ | | DRU I PYJEVE MALORE AKTORE E NJOHUR AMERIKANE | | | |
| FUSHË- BETEJA | ○ | | | | GOTË E METALTË | KOMPOZITORI YNË, PRESHEVA |
| VENDI KU NGJITEN- RREGULLOHE GOMAT | ○ | | | | | MUAJI I AGJËRIMIT TE MYSLI- MANËT |
| AKTORJA, GARDNER | ○ | | | KRYEQYTETI I NIKARAGUAS MASURËT | | INTENSITET, GRAM |
| LIKUDIM, ZHUKUJE SHKOJ PËRPARA, PËRPAROJ | | | | | | RIÇARD GIR QENDËR E INDUSTRIË FILMIKE AMERIKANE |
| AMPER | | AJËR (lat.) PJESË E TV MARRËSIT | | | ORË EMËR I HUAJ MASHKULLI | |
| LUGAT | | | | | PERËNDIA JO AKTIV | |
| AGJENCI GAZETARES, ITALIANE | | | | LLOJ GURI I ÇMUAR PERENDI E VJETER EGJIPTASE | | VOLT PREFIKS ME KUPTIM: SHUMË I MADH |
| SIMBOLI KIMIK I NITON-it | | | NDËRTIMI I TAVANIT GRUP KËNGËTARË RËSH | | | |
| ZË NË GOJË, PËRMEND | | | | SASI E MADHE, MASË E MADHE (sh.) TANTAL | | |
| NJËLLOJËSI, I MËRZITSHËM | | | | | | QYTET NË DANIMARKË SPANJA |
| ▶ | | | | | | |
| MIK I AFËRT, SHOK | | | | | SHKRIMTARI YNË, KOKONA | |



FJALËKRYQ KLASIK



HORIZONTALISHT:

1. Fushatë; 7. Motra e babait; 8. Rënia në gjumë të thellë (mjek.); 10. Shtëpi madhështore; 11. Familje italiane ndërtues të violinave; 13. *Internation. Boxer Amateur*; 14. Vigan në mit. Greke; 16. Fill i hollë prej metali; 17. Adelina Ismajli; 18. Banor i Kroacisë; 20. Aktori amerikan, Marvin; 21. Filozofi gjerman, Niçe; 23. Dru pylli me fletë si të dardhës (bot.); 25. Mbarësi, fat (shq.); 27. Tufë bagëtish; 28. Futbollisti ynë, Rudi; 29. Zifti (krah.).

VERTIKALISHT:

1. Ndeza (krah.); 2. Sipas mënyrës (.....frënga,turka); 3. Rregullimet, mbarështimet; 4. Monopolizova; 5. Lag pak që të zbutet; 6. Nënata; 7. Çudi; 9. Lloj majmuni; 10. Vegël muzikore; 12. Paraardhësi jonë (shq.); 15. Njësi angleze për dru; 18. Lëndë e njelmët kristallore; 19. Enë për të fërguar; 21. Qimet e kokës; 22. Një lloj bufi (shq.); 24. Kevin Kostner; 26. Radium.

ZGJIDHJET: LINDJA, JENICËR, JAK, N. DUELI, IGLU, GU, AH, ARENA, R. GOMISTERI, I, AVA, MANAGUA, ASGJËSIM, RK, A, AER, SAHAT, VAMP, R, ZOTI, ANSA, OPAL, V. NT, TAVANIMI, CEK, MASIVET, MONOTONI, UË, JARAN, VEDAT, FJALËKRYQ, KLASIK, KAMPANJE, HALLA, KOMA, PALLAT, AMTI, IBA, ALP, TEL, AI, KROAT, LI, N, FRIDRIH, R, OKLIM, OGURI, KOPE, VATA, KATRANI.

REKORD GUINNESS

BERBERI 107 VJEÇ: S'KAM NË PLAN TA LË PUNËN

Të gjithë e kërkojnë dhe të gjithë e duan sepse eksperiencën e tij 95-vjeçare nuk e ka askush. Bëhet fjalë për berberin Anthony Mancinelli, i cili jeton në New York, 107 vjeç dhe nuk e ka në plan të dalë në pension.

"Unë kam lindur në Itali, afër Napolit. Kam nisur të punën si berber këtu në Amerikë kur isha vetëm 12 vjeç dhe që atëherë nuk më mungojnë asnjëherë klientët"- ka thënë 107-vjeçari.

Anthony ka një dyqan që quhet "Fantastic Cuts" dhe është 100 kilometra larg New York-ut. Në vitin 2007, 107-vjeçari ka hyrë në librin e rekordeve, Guinness.



Ai nuk ka pirë asnjëherë alkool e cigare dhe tregon se ha gjithçka. Kur është pyetur për sekretin e jetëgjatësisë së tij ai është përgjigjur se është Zoti lart.



Lulëzojnë qershitë në Japoni

Tajfunët e shpeshtë që kanë goditur Japoninë prej verës deri në javët e fundit, kanë favorizuar lulëzimin e qershive. Nga zona jug-perëndimore e Kyushu në pjesën veriore të Hakkoido, ekspertët janë njoftuar për prezencën e luleve në pemë, një fenomen që zakonisht ndodh në Japoni në Pranverë.

Imamët pas gati 40 vitesh zbulojnë se janë lutur në drejtim të gabuar

Adhuresit në xhaminë turke kanë qenë duke u lutur në rrugën e gabuar për afro 40 vjet.

Xhamia në Sugoren në perëndimin e vendit u ndërtua gabimisht në vitin 1981, njofton 'Daily Mail', transmeton IndeksOnline.

Lutjet do duhet të drejtohen kah Qabja, e cila është në qendër të vendit më të shenjtë të Islamit në Mekë, Arabinë Saudite. Si një zgjidhje e përkohshme, Kaya vendosi shigjeta të shiritave të bardhë për të treguar kahjen e saktë se kah do duhej të falen besimtarët.



Ushtria zvicerane padit firmën e njohur, ja arsyeja

Kompania Victorinox është themeluar nga 1884 dhe prodhon aoma thika për familjarët. Prej 1891 ajo ka prodhuar thika edhe për ushtarët zviceranë— ndaj në gjithë botën njihet si kompani e njohur që përfaqëson mirë helvetët.

Megjithatë Victorinox ndodhet përpara Gjykatës dhe kjo për shkak të padisë të lëshuar nga Zvicra, përcjell albinfo.ch.

Erdogani bën "gati" burgun për Arda Turanin

Futbollisti Arda Turan po kalon momente të vështira ditëve të fundit, pasi akuzohet për ushtrim dhune ndaj një këngëtarit të njohur në Turqi.

Por, problemi nuk është vetëm në këtë çështje, sepse ai po akuzohet edhe nga pushteti turk si i përfshirë në puçin ushtarak, i cili ndodhi në vitin 2016.

Sipas gazetës turke, 'Hurriyet' hetimet për lojtarin e Barcelonës janë duke vazhduar, i cili pas tyre, mund të rrezikojë një dënim prej 12 vite burg. Turan është i huazuar në Istamboll Başakşehir. Telashet nuk mbarojnë këtu. Lojtari i Barcelonës i huazuar në Turqi do të përballet edhe me akuzën si armëmbajtje pa leje.



20 Nëntori është dita e 324-të e kalendarit gregorian (dita e 325-të në vitin e brishtë) — kështu që deri në fund të vitit kanë mbetur edhe 41 ditë.

284 — Diokleciani bëhet perandor romak. Ai vjen në këtë post ndërsa perandoria sapo kishte dalë nga një periudhë anarkie. Gjatë kohë në detyrë, Diokleciani restauroi efikasitetin e qeverisë, riorganizoi makësinë fiskale dhe hodhi bazat e perandorisë romake lindore ose bizantine. Ai u dallua edhe si përndjekës i të krishterëve, pasi besonte se Jupiteri ishte i vetmi Zot. Si zv/perandor, ai kishte zgjedhur Konstandinin, i cili u bë perandor pas vdekjes së Dioklecianit. Ashtu si Konstandini, edhe Diokleciani rridhte nga një familje nga Iliria e pushtuar romake, në Salona të Dalmacisë dhe emri i tij i lindjes ishte Diokles.

1940 — Lufta e Dytë Botërore: Hungaria bëhet nënshkruese e Paktit Trepalësh, duke iu bashkuar zyrtarisht fuqive të Boshtit Berlin — Romë. Nga kjo lidhje, Hungaria përfitoi territore nga Çekosllovakia e Rumania. Edhe pse fillimisht Budapesti kishte shpresuar për të shmangur përfshirjen e drejtpërdrejtë në luftë, në vitin 1941, forcat hungareze morën pjesë në pushtimin nazist të Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik.

1989 — Revolucioni Kadife: numri i protestuesve të mbledhur në Pragë rritet nga 200-mijë një ditë më parë në rreth gjysmë milion. Dita universale e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Edhe kafshët, njësoj si njerëzit betohen për 'dashuri të vërtetë'. Madje, disa prej tyre janë aq të përkushtuar ndaj partnerit sa vetëm vdekja mund t'i ndajë. Ja se kush janë: Dashuria mes dy pinguinëve zgjat përgjithmonë. Ata shumë rrallë mund të ndodhë që të ndryshojnë partner. Mjelmata qëndrojnë besnike në çift deri në fund të jetës. Jeta familjare e mjelmave ka cilësi shumë të mira, duke përfshirë miqësinë, kujdesin dhe dhembshurinë. Ujqit njihen si kafshë shumë të dhëna në marrëdhëniet e tyre. Ujku i përkushtohet shumë partneres së tij dhe prej saj mund ta ndajë vetëm vdekja. Tek kastorët femra është përgjegjësjë e familjes. Sekretin e marrëdhënies së tyre të gjata dhe të lumtura është mençuria e partneres femër.



Demat
Një vajzë fshati është mbështetur në murin rrethues të kopesë së demave kur vjen një makinë, nga e cila zbrit një zotëri e i thotë:
— Dua të flas me babain tënd.
— Babi është i zënë, por nëse jeni i interesuar për të blerë një dem, jua tregoj unë çmimet. Një dem me pemë gjenealogjike dhe me rezultat të sigurtë, kushton 500 euro; një që ka garanci në rezultat, por nuk ka pemë gjenealogjike 250 euro, kurse një dem pa garanci dhe pa pemë gjenealogjike, 100 euro...
— Moj vajzë... Dua të flas me tët atë sepse vëllai yt ka lënë shtatzënë vajzën time...
— Ah... atëherë duhet të prisni patjetër tim atë, se vëllai nuk ia di çmimin...



Nuk ka njeri, sado i zgjuar, që në një periudhë kohore të rinisë së tij të ketë thënë gjëra, ose të ketë jetuar në një mënyrë që ndërgjegjes së tij të tashme mos t'i pëlqejnë më
(Marcel Proust)



KALENDARI HISTORIK 20 TETOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS